

UNIVERSITETI PUBLIK “KADRI ZEKA”
FAKULTETI JURIDIK
PROGRAMI: JURIDIK-PENAL
NIVELI: MASTER



Tema: Tortura dhe trajtimi çnjerëzor në vështirim të akteve ndërkombëtare dhe në aspektin krahasues Kosovë-Shqipëri

Mentor:
Prof. asoc.dr. Albulena Hajdari Krasniqi

Kandidatja:
Hasime Hoti

Gjilan, 2024

Mirënjohje

Dëshiroj të shpreh një mirënjohje të thellë dhe të sinqertë për profesoreshën e nderuar Prof. Asoc. Dr. Albulena Hajdari, falë mbështetjes dhe këmbënguljes të së cilës është përmbushur kjo temë Masteri.

Një mirënjohje të veçantë shpreh për familjen time, e cila me shumë durim ka qenë pranë meje gjatë rrugëtimit të këtij procesi.

Një falënderim nga zemra për miqtë e mi që më kanë qëndruar pranë gjatë gjithë kësaj periudhe, kanë besuar tek aftësitë e mia dhe më kanë nxitur në mënyrë të vazhdueshme për tu avancuar në karrierën profesionale, e veçanërisht në përfundimin e këtij punimi.

Gjithashtu, dëshiroj të shpreh falenderime për të gjithë kolegët dhe profesorët që më kanë mbështetur, të cilët realisht janë të shumtë dhe për të cilët, vetëm përmendja e secilit në këto pak rreshta, thjesht do të ishte e pamjaftueshme.

Mirënjohje dhe faleminderit të gjithëve!

Deklaratë Etike

Unë, Hasime Hoti, me përgjegjësi të lartë morale dhe etike, deklaroj se ky studim është punë origjinale dhe personale e imja e cila është bërë duke respektuar në përpikmëri autorësinë dhe nuk përmban material të shkruar nga ndonjë person tjetër përpos rasteve që i kam cituar në punim.

PËRMBAJTJA

Abstrakti	6
PJESA HYRËSE	9
1.Qëllimi dhe objektivat e trajtimit të torturës e trajtimeve çnjerëzore.....	10
2.Hipotezat	11
3.Metodologjia	11

KAPITULLI I

VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM MBI ZHVILLIMIN HISTORIK TË TORTURËS, DËNIMEVE DHE TRAJTIMEVE ÇNJERËZORE E DEGRADUESE

1.Kuptimi dhe përdorimi i torturës në zgjidhjen e konflikteve penale	13
2.Shfuqizimi i torturës gjyqësore, një hap i rëndësishëm në mbrojtjen e të drejtave të njeriut	15
3.Tortura dhe trajtimi çnjerëzor i të dënuarve me burgim	16
4.Dënimi me vdekje	19

KAPITULLI II

TORTURA DHE TRAJTIMET ÇNJERËZORE E DEGRADUESE NË VËSHTRIM TË AKTEVE NDËRKOMBËTARE

1.Kuptimi i torturës dhe trajtimeve çnjerëzore sipas Konventës kundër Torturës dhe Trajtimeve e Dënimeve të Tjera Mizore, Çnjerëzore ose Poshtëruese	22
2.Obligimet dhe përgjegjësitë që rrjedhin nga Konventa kundër Torturës dhe Trajtimeve a Dënimeve të Tjera Mizore, Çnjerëzore ose Poshtëruese për shtetet	27
3.Obligimet në ndërlidhje me themelimin e Komitetit kundër torturës	28
4.Tortura dhe trajtimet çnjerëzore e degraduese sipas Konventës Evropiane për të Drejtat e njeriut.....	31

5.Tortura dhe trajtimet çnjerëzore e degraduese sipas praktikës së Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut	33
6.Analiza e nenit 3 të K.E.D.NJ.-së sipas jurisprudencës së GJ.E.D.NJ.-së	34

KAPITULLI III

TORTURA DHE TRAJTIMET ÇNJERËZORE E DEGRADUESE NË ASPEKTIN KRAHASUES KOSOVË - SHQIPËRI..... 41

1.Tortura dhe trajtimeve çnjerëzore sipas Kodit Penal të Kosovës	41
1.1.Kuptimi i torturës dhe trajtimeve çnjerëzore	42
1.2.Elementet përbërëse të torturës dhe trajtimeve çnjerëzore	44
1.3.Karakteristikat e torturës dhe trajtimeve çnjerëzore	45
2. Tortura dhe trajtimeve çnjerëzore sipas Kodit Penal të Shqipërisë	45
2.1.Kuptimi i torturës dhe trajtimeve çnjerëzore	46
2.2.Elementet përbërëse të torturës dhe trajtimeve çnjerëzore	47
2.3.Karakteristikat e torturës dhe trajtimeve çnjerëzore	50
3.Elementet e përbashkëta dhe dalluese në ndërlidhje me torturën dhe trajtimet çnjerëzore të manifestuara në Kodin Penal të Kosovës dhe Kodin Penal të Shqipërisë	51

Konkluzione dhe rekomandime 53

Bibliografia 58

Shkurtesat

G.J.E.D.NJ.	Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut
K.E.D.NJ.	Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut
KPK	Kodi Penal i Kosovës
K.P.T .D.T. Ç. D.	Komitetit për Parandalimin e Torturës dhe Dënimeve apo Trajtimeve Çnjerëzore ose Degarduese
O.K.B.	Organizata e Kombeve të Bashkuara
U.N.C.A.T Torturës	Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Torturës

ABSTRAKTI

Ky punim do të ofrojë një përshkrim historik të formave të torturës, duke përfshirë një analizë të torturave dhe trajtimeve çnjerëzore gjatë procesit gjyqësor dhe gjatë kohës së vuajtjes së dënimit, si edhe trajtimin e ideve të para që në histori shënuan një kapitull të ri me heqjen e dënimit me vdekje ose ndalimin e torturës. Punimi trajton në mënyrë analitike sa i përket historisë, ashtu edhe progresit që kanë sjellë aktet ndërkombëtare të miratuara nga Kombet e Bashkuara dhe Këshilli i Evropës për ndalimin e torturës dhe trajtimin çnjerëzor dhe degradues. Një vëzhgim i detajuar i dedikohet Konventës kundër torturës dhe trajtimeve a dënimeve të tjera mizore, çnjerëzore ose poshtëruese, Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut dhe jurisprudencës së Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut për shkak të kontributit të jashtëzakonshëm që ka sjellë kjo e fundit jo vetëm në përmirësimin e legjislacioneve të vendeve të ndryshme, por në të njëjtën kohë edhe në vetë përcaktimin e përkufizimit të elementeve të torturës, trajtimin çnjerëzor dhe trajtimin degradues. Nëpërmjet krahasimit të treguesve të aplikantëve pranë GJ.E.D.NJ.-së, në këtë punim evidencohet një pasqyrë e shteteve të cilat janë ndëshkuar më shumë nga GJ.E.D.NJ. për shkak të shkeljeve të nenit 3 të Konventës. Po ashtu, trajtohen në mënyrë krahasimore e analitike legjislacionet e disa vendeve të Bashkimit Evropian dhe atyre jashtë tij duke pasqyruar progresin e arritur, e ndikuar kjo nga vendimet apo gjykimet pilot të GJ.E.D.NJ.-së. Ky studim i bën një vështrim edhe aspektit krahasimor të trajtimin të torturës dhe trajtimeve çnjerëzore të pasqyruar në Kodin Penal të Kosovës dhe atij të Shqipërisë. Një pasqyrë e plotë është punuar në këtë temë sa u përket problematikave të institucioneve penitensiare, duke i trajtuar në këndvështrimin e jurisprudencës së GJ.E.D.NJ.-së dhe elementeve të nenit 3 të Konventës. Punimi në përfundim të tij paraqet konkluzionet dhe rekomandimet që lidhen jo vetëm me aspekte të ndryshimeve në legjislacionin penal, por edhe me ato të zbatueshmërisë në praktikë.

Fjalë kyçe: Torturë, trajtim çnjerëzor dhe degradues, dënim me vdekje, K.E.D.NJ., GJ.E.D.NJ.

PJESA HYRWSE

Në kohët e fundit, ndërtimi i shoqërive në të cilat sundon shteti i së drejtës dhe ku respektohen të drejtat e njeriut është një sfidë ndërkombëtare. Për vite me radhë është zhvilluar një punë e jashtëzakonshme për të ndërtuar ligje të drejta mbi bazën e të cilave mbështetet veprimtaria e shteteve, duke siguruar nga njëra anë ruajtjen e rendit, paqes, sigurisë mes njerëzve dhe nga ana tjetër mbrojtjen e atyre të drejtave të cilat janë të pacenueshme. E drejta për t'u mbrojtur nga tortura dhe trajtimet jonjerëzore apo degraduese zë një vend të madh, pasi që kjo e drejtë nuk mund të konkurrohet nga asnjë prej të drejtave themelore për shkak të karakterit të saj absolut dhe të paderogueshëm. Duke mbajtur në konsideratë këtë aspekt, qëllimi i realizimit të këtij punimi ishte zhvillimi më tej i mendimit juridik lidhur me zhelimin dhe risitë që sjellë e drejta e ndalimit të torturës dhe trajtimit çnjerëzor apo degradues në aspektin ndërkombëtar dhe atë kombëtar. Kërkimi shkencor që prezantohet në këtë punim lidhet me vështirimin historik në periudha të ndryshme të përdorimit të torturës dhe trajtimit çnjerëzor apo degradues, në zhvillimin e instrumenteve ndërkombëtare për ndalimin e saj duke e konsideruar si një të drejtë absolute, në risitë dhe progresin që ka ardhur pas jurisprudencës së Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut, në krahasimin e trajtimit të torturës dhe trajtimit çnjerëzor apo degradues nga legjislacionet e vendeve të ndryshme anëtarë të Këshillit të Europës, ashtu si në garancitë dhe parashikimet legjislative dhe të zbatimit në praktikë.

Bazuar në analizat që kam kryer në fund kam nxjerrë disa përfundime dhe sugjerime të rëndësishme në lidhje me të drejtën e mbrojtjes nga tortura dhe trajtimet jonjerëzore, duke përmendur edhe rekomandime të rëndësishme sa i përket përmirësimit të legjislacionit të brendshëm dhe mënyrës së trajtimit të të dënuarve dhe të paraburgosurve në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale, si në aspektin strukturor edhe në atë infrastrukturor.

Në Kapitullin I është paraqitur hyrja e punimit, qëllimi dhe objektivat që synohen të arrihen, hipotezat dhe metodologjia e përdorur për këtë punim.

Në Kapitullin II është trajtuar fillimisht tortura në këndvështrimin historik, duke e analizuar atë në format e hershme procedurale, akuzatore dhe inkuizitore, duke vënë në dukje rëndësinë e përdorimit të torturës në zgjidhjen e konflikteve dhe dhënien e drejtësisë. Në këtë

këndvështrim me rëndësi paraqitet edhe zhvillimi historik i trajtimit të të dënuarve për t'u ndalur në fund në arsyet që dërguan në ndalimin me ligj të torturës.

Në Kapitullin III të këtij punimi trajtohen aktet ndërkombëtare të miratuara, duke u nisur nga idetë e para për ndalimin e torturës, dënimeve me vdekje, duke vazhduar më tutje me ngritjen e komisioneve monitoruese deri tek krijimi i institucioneve dhe mekanizmave ndërkombëtar dhe kombëtar për të garantuar ndalim të torturës dhe trajtimin çnjerëzor dhe degradues. Pastaj bëhet trajtimi i nenit 3 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut. Ky trajtim bëhet mbi bazën e zhvillimeve të jurisprudencës së Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut që prej fillimeve të saj e deri në ditët e sotme. Jurisprudenca e kësaj Gjykate është analizuar edhe për mënyrën se si e trajton çështjen e nenit 3 të K.E.D.NJ.-së, i cili është i ndërlidhur me mbrojtjen e së drejtës së jetës parashikuar nga neni 2 i po kësaj Konvente.

Në Kreun IV analizohet legjislacioni penal kosovar dhe pastaj shqiptar në aspektin krahasues që ndëshkon torturën dhe sjelljet e tjera të jashtëligjshme, të ngjashme me të dhe respektimi i të drejtave të personave të privuar nga liria në institucionet penitenciare kosovare, duke sjellë jo vetëm përfundimet dhe rekomandimet e mekanizmave ndërkombëtarë dhe atyre kombëtarë, por në të njëjtën kohë duke i vlerësuar në aspektin krahasues të të dhënave sasiore dhe jurisprudencës së Gjykatës së Strasburgut.

1.Qëllimi dhe objektivat e trajtimit të torturës e trajtimeve çnjerëzore

Ka një numër të madh të faktorëve dhe arsyeve që më kanë shtyrë të bëjë trajtimin e kësaj tematike. Shumë shpesh dëgjohet për përdorimin e torturës dhe trajtimit jonjerëzor edhe pse me përparimet e mëdha që janë bërë në legjislacione të shteteve si dhe me akte të tjera ndërkombëtare këto dy problematika do të duhej që të mbeteshin në të kaluarën. Gjithashtu, për trajtimin e kësaj tematike ka ndikuar edhe interesimi për të parë evoluimin e të drejtave të njeriut, që kur ka lindur për herë të parë ideja e largimit të dënimit me vdekje, ndalimit të torturës, rëndësia që ka pasur Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, rëndësia që ka pasur Konventa kundër torturës dhe trajtimeve a dënimeve të tjera mizore, çnjerëzore ose poshtëruese etj.

Arsye tjetër ka qenë edhe interesimi për të bërë një analizë të nenit 3 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, dhe nga ajo që kam hulumtuar pashë se në gjuhën shqip nuk ka edhe shumë punime hulumtuese apo shkencore lidhur me temën në fjalë.

Ky punim do të ketë këto objektiva:

1. Të analizojë torturën në procedurën akuzatore, inkuizitore dhe atë të përzier,
2. Të analizojë zhvillimin historik të trajtimit të të dënuarve,
3. Të analizojë aktet ndërkombëtare të miratuara,
4. Të analizojë nenin 3 të KEDNJ,
5. Të analizojë legjislacionin penal të Kosovës që ndëshkon torturën, dhe
6. Të analizojë legjislacionin penal të Shqipërisë që ndëshkon torturën.

2. Hipotezat

Hipoteza 1: Vepra penale e torturës dhe trajtimit çnjerëzor e degradues dënohet me legjislacionin kosovar.

Hipoteza 2: Vepra penale e torturës dhe trajtimit çnjerëzor e degradues dënohet me legjislacionin shqiptar.

Hipoteza 3: Tortura dhe trajtimet çnjerëzore ndalohen me aktet përkatëse ndërkombëtare.

3. Metodologjia

Pyetjet e paraqitura dhe hipotezat e ngritura kanë nevojë jo vetëm për kërkime shkencore dhe akademike por edhe për analizë të legjislacionit penal lidhur me trajtimet jo njerëzore. Për arritjen e rezultateve të kërkuara do të përdoren disa metoda.

Me qëllim të hulumtimit sa më të mirë të pjesës historike të paraqitjes së dënimeve dhe trajtimeve jonjerëzore do të përdori *metodën historike*.

Për të bërë analizë më të mirë të legjislacionit tonë në lidhje me trajtimin çnjerëzor dhe degradues do të shërbelemi me *metodën analitike-normative*.

Për të parë si është legjislacioni i Kosovës në raport me legjislacionin e Shqipërisë për çështjen e torturës dhe trajtimit çnjerëzor e degradues do të përdorim *metodën krahasimore*.

KAPITULLI I

VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM MBI ZHVILLIMIN HISTORIK TË TORTURËS, DËNIMEVE DHE TRAJTIMEVE ÇNJERËZORE E DEGRADUESE

1.Kuptimi dhe përdorimi i torturës në zgjidhjen e konflikteve penale

Në këndvështrimin etimologjik, fjala “torturë” e ka prejardhjen nga fjala latine ‘torquere’, që nënkupton të gjitha format e shtrëngimit fizik apo psikologjik ku qëllimi i tyre është marrja e informatave të vlefshme ose ndëshkimi i personit.¹ Nëse nisemi nga kjo mund të vërejmë dy lloje të ndryshme të torturave: a) e para është tortura gjyqësore e cila është përdorur gjatë zhvillimit të procedurës penale, dhe atë përgjatë procedurës inkuizitore kua ajo është konsideruar e ligjshme dhe e lejuar për sigurimin e provave mbi të cilat do të mbështetej vendimi gjyqësor, dhe b) e dyta është tortura që në fakt ishte dënim që nuk zhvillohej brenda procedurës penale, por në një moment pas tij dhe që vinte si pasojë e tij. Në rastin e dytë duhet bërë dallimin në mes torturës si dënim, e cila është quajtur ndryshe edhe dënim-torturë, dhe torturës që kishte të bëjë me mënyrën e trajtimit të personit gjatë vuajtjes së dënimit. Këtu vlen të ceket se historia e torturës është shumë e hershme dhe është përdorur qysh në kohët antike nga popujt e ndryshëm. Të gjithë popujt dhe shtetet që e kanë përdorur torturën kanë pasur të njëjtin qëllim në zbatimin e saj, faktin se përdorimi i metodave mizore është gjithmonë i justifikuar nga interese të rëndësishme që ka të bëjë me sigurinë e shtetit, luftën ndaj kriminalitetit, mbrojtjen e fesë etj. Pavarësisht kësaj, në thelb janë konsideruar si metoda të urryera, të pavlera dhe jo produktive.²

Tortura shpjegohet si një sulm direkt dhe i vazhdueshëm në elementet më të rëndësishme të personalitetit dhe dinjitetit të njeriut. Ashtu si dhe skllavëria, tortura ka për qëllim privimin e njerëzve nga të qenurit njerëzor. Sipas një doktrine, në një kohë që “skllavëria” i privon qeniet njerëzore ex lege nga statusi i tyre human dhe njerëzor, duke lejuar kështu që ai i cili i shfrytëzon të ketë të drejtën e ushtrimit të drejtave të skllavit, tortura e përshkruan një situatë në të cilën një person ushtron fuqi faktike të pakufizuar ndaj një personi tjetër.³

¹ Për më shumë rreth këtij koncepti, shih: G. Serges, La tortura giudiziaria: Evoluzione e fortuna di uno strumento d'imperio, në L. Pace, S. Santucci, G. Serges, Momenti di storia della giustizia, Aracne, Roma, 2011, fq. 215.

² Ibid, fq. 225.

³ M. Nowak, E. McArthur, The United Nations Convention Against Torture - A Commentary, në Ph. Alston, V. Lowe (ed.), Oxford Commentaries on International Law, Oxford University press, Oxford, 2008, fq.1.

Pavarësisht kësaj në kuadër të respektimit të drejtave të njeriut dhe garantimit të një procedure të drejtë, një rëndësi të madhe ka studimi historik i torturës gjyqësore: këtu bëhet fjalë për torturën e përdorur nga magjistratët kundër personave nën hetim, bashkëpunëtorëve të tyre apo dëshmitarëve me qëllim që të merreshin informata të rëndësishme për rrjedhën e hetimeve tutje. Në këtë këndvështrim, me rëndësi është edhe studimi i mënyrës së trajtimit të të dënuarve në aspektin historik dhe rastet e trajtimeve jonjerëzore të cilat në vete përbëjnë një formë tjetër torture jo më pak të rëndësishme se tortura e përdorur për zgjidhjen e procedurës gjyqësore. Përdorimi i torturës gjyqësore është i lidhur ngushtë me zhvillimin historik të procedurës penale pasi që kjo lloj torture është përdorur për të zgjidhur konfliktet penale, me qëllim të përcaktimit të fajësisë dhe dënimit e autorëve të veprave penale. Për këtë është me rëndësi trajtimi dhe analiza e rasteve të përdorimit të torturës gjatë zhvillimit historik të procedurës penale dhe rolin që ka pasur ajo në zgjidhjen e konflikteve dhe zhvillimin e formave të saj.

Për zgjidhjen e konflikteve penale në etapa të ndryshme kohore janë përdorur rregulla të ndryshme ku tërësia e këtyre rregullave formonte një procedurë të caktuar mbi të cilën mbështetej zhvillimi i procesit penal, në përfundim të të cilit caktohej fajësia ose pafajësia e të pandehurit. Pavarësisht procedurës që është përdorur, rëndësi të madhe për zgjidhjen e konflikteve penale ka pasur zbulimi i së vërtetës. Secila e vërtetë duhej të mbështetej në prova të pakontestueshme për marrjen e të cilave përdoreheshin mjete të ndryshme varësisht sipas formës së përdorur për zhvillimin e procedurës penale. Historia e zhvillimit të procedurës penale ka njohur dy mënyra të ndryshme për sigurimin e provave dhe zbardhjen e së vërtetës, por në thelb ato paraqesin të njëjtin funksion, *torturën*. Përpara se të shpjegojmë se çfarë kuptohej me secilën dhe kur është përdorur njëra ose tjetra, me interes është paraqitja e karakteristikave kryesore të formave të ndryshme të procedurës penale. Duke shikuar burime të shumta historike, në mesjetën e largët pas rënies së Perandorisë Romake të Perëndimit, për zgjidhjen e konflikteve në Europën Perëndimore zbatoheshin rregullat e procesit akuzator. Në këtë periudhë, më shumë se për shtete mund të flasim për popuj të organizuar në fise ku mungonin strukturat e vërteta shtetërore. Në fushën penale zbatoheshin një traditë e vjetër gjermane që mbështetej në hakmarrjen private. Sipas A. Capone, kishte të bënte me komunitete të barabarta, me njerëz të lirë, për të cilët ishte e pakuptueshme

ekzistenca e një autoriteti superior që do të zhvillonte hetime, do të drejtonte procedura dhe do të jepte dënime.⁴

2.Shfuqizimi i torturës gjyqësore, një hap i rëndësishëm në mbrojtjen e të drejtave të njeriut

Përdorimi i torturës gjatë procesit inkuizitor nënkuptonte mosrespektim apo shmangie të përdorimit të drejtësisë nga ana e pushtetit ekzekutiv. Kundër kësaj forme jo demokratike, në periudhën e iluminizmit kishin filluar të lindin lëvizje përparimtare kundër padrejtësive dhe mënyrës së organizimit të pushtetit politik.⁵

Disa nga kërkesat kryesore që proklamnin përkrahësit e këtyre lëvizjeve ishin pikërisht reformimi i sistemit të drejtësisë, dhënia e drejtësisë nga një gjyqtar profesionist, i paanshëm dhe i pavarur nga pushteti ekzekutiv, shfuqizimi i torturës, si dhe mbrojtje nga keqtrajtimi i të dënuarve me burgim.

Një dokument me rëndësi i kësaj periudhe, i cili ka të bëjë me shfuqizimin e torturës dhe heqjen e dënimit me vdekje në zgjidhjen e konflikteve penale, është edhe Kodi Penal i miratuar në rajonin e Toskanës në Itali nga Pietro Leopoldo, i quajtur edhe “Kodi i Leopoldinos” në vitin 1786.⁶

Në ndërtimin e këtij Kodi, Pietro Leopoldo kishte shfrytëzuar punën e juristëve më të mirë të kohës që ishin kundër përdorimit të torturës në procedurat penale. Një ndër këta ishte edhe Cesare Beccaria, i cili me veprën e tij “Krimet dhe dënimet”, të botuar në vitin 1764, kishte hedhurbazat e shfuqizimit të torturës dhe dënimit me vdekje. Në lidhje me torturën, Beccaria, i cili konsiderohej si babai i kriminologjisë moderne dhe i frymëzuar nga Montesque, ishte i mendimit se tortura është në konflikt me kërkimin e së vërtetës që duhet të jetë katalizatori i zhvillimit të procesit penal. Beccaria kishte trajtuar më tej se përdorimi i torturës mund të çonte në zgjidhje jo të vërteta, ku në fakt reagimi ndaj torturës është subjektiv dhe varet nga rezistenca

⁴ A. Capone, Storia, cultura e principi nel processo penale, Università degli Studi Mediterrani di Reggio Calabria, 2016, fq. 27.

⁵ J. Graven, Le problème des nouvelles techniques d'investigation au proces penal, në Revistën shkencore Revue de science criminelle et de droit penal compare, Nr. 3, botuar nën kujdesin e Institutit të Kriminologjisë dhe Institutit të së Drejtës Krahësuese të Universitetit të Parisit, Paris, 1950, fq. 316.

⁶ V. Parlato, Pietro Leopoldo: Un principe riformatore, në Revistën shkencore Studi Urbinati, Vol.67, Nr. 3-4, Universiteti i Urbino, Urbino, 2016, fq. 409-411.

fizike dhe psikologjike e personit në lidhje me dhimbjen. Si pasojë, në shumë raste tortura shndërrohet në mjet të sigurt për të liruar fajtorët e fuqishëm dhe për të dënuar personat e pafajshëm të dobët.

Në veprën e tij "Krimet dhe dënimet", Beccaria kishte parë një nevojë të madhe për të reformuar sistemin e drejtësisë penale, duke theksuar nevojën e ndëshkimit të përshtatshëm dhe të drejtë dhe shkoi deri aty sa shpjegoi se sistemi duhej të përcaktonte dënimin e duhur për secilin lloj të veprës

penale. Në këtë punim të tij ai përfshiu një diskutim të strategjive të parandalimit të krimet. Me shfuqizimin e torturës gjyqësore të kryer në Evropë gjatë periudhës së reformave të mëdha dhe lindjes së shteteve demokratike që kishin në themel të tyre mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe krijimin e garancive në fushën procedurale penale, mori fund edhe diskutimi mbi torturën gjyqësore.⁷

3.Tortura dhe trajtimi çnjerëzor i të dënuarve me burgim

Studimi i mënyrës së trajtimit të të dënuarve në aspektin historik ka rëndësi të madhe sikurse studimi i torturës që është përdorur për zgjidhjen e konflikteve penale. Mënyra e trajtimit të të dënuarve është e lidhur me nocionin e dënimit dhe funksionet që shoqërojnë zbatimin e tij. Ndëshkimi i autorit të veprës penale nëpërmjet shkaktimit të vuajtjeve të ndryshme si për shkak të veprimit të jashtëligjshëm të kryer nga ai nuk na tregon në mënyrë të qartë për objektivin konkret që legjislatori dëshiron të arrijë.⁸

Sipas V. Hysi, fillimisht në rastin e zbatimit të dënimeve me karakter publik, burgu konsiderohej më shumë si një mjet për kufizimin e lirisë ku qëndronin të arrestuarit dhe të paraburgosurit me qëllim që të mos të shmangeshin nga gjykimi. Sanksionet në këtë periudhë ishin të ndryshme, nga dënimi me vdekje tek puna në minierë, rrahja me kamxhik, dëbimi dhe deri te gjoba që ishte një nga dënimet më të zbatuara.⁹

⁷ <https://www.biography.com/scholar/cesare-beccaria>.

⁸ Troncone, Manuale di diritto penitenziario, Giappichelli editore, Torino, 2006, fq.7.

⁹ V. Hysi, Penologjia, vepër e cituar, fq. 33-36.

Në këtë kohë dënimi me burg ishte një torturë në kuptimin e plotë të fjalës, sepse vuajtja e dënimit realizohej në mjedise dhe me metoda jo përshtatshme që të shkaktonin vuajtje të rënda psikologjike dhe fizike. Përdorimi i burgjeve për dënimin e kryerësve të veprave penale shënon edhe lindjen e sistemit penitensiar dhe problemeve me të cilat ky sistem do të përballlej. Duke qenë se qëllimi kryesor i dënimit ishte lidhur me ndarjen e të dënuarve nga pjesa tjetër e shoqërisë, problemet e para penitensiare kishin të bënin me sigurinë dhe me policinë e burgjeve. Trajtimi i të dënuarve nuk ishte i rëndësishëm dhe për këtë arsye, mënyra e ekzekutimit të dënimeve përbënte torturë për të dënuarin. Përpjekjet e para të ndëshkimit për qëllim riedukimin e të dënuarit do të shfaqen në shek. XVI duke i dhënë jetë një ideologjie të re penitensiare. Në lidhje me këtë argument, burime historike bëjnë me dije se në vitin 1557 u krijua në Angli institucioni i parë penitensiar, “House of Correction” ose “Workhouse”, që kishte si qëllim të përmirësonte personat që vendoseshin në të nëpërmjet punës dhe disiplinës. Me shfaqjen e mendimeve iluministe fillon të ndryshojë edhe qasja ndaj kuptimit të qëllimeve të dënimit dhe si rrjedhojë, fillon të ndryshojë edhe mënyra e ekzekutimit të tyre.¹⁰ Gjatë shekujve XIII XV, dënimi me burgim zbatohet vetëm mbi bazën e provës ligjore. Qëllimi kryesor i dënimit në këtë periudhë ishte lidhur me ndëshkimin e fajtorit dhe me parandalimin e kriminalitetit. Kjo është periudha kur tortura përdorej për të marrë provën ligjore dhe për të ndëshkuar kryerësin e veprës penale. Në praktikë kemi shumë raste për mënyrën e ekzekutimit të dënimeve penale, si për shembull në rastin e dënimit me vdekje kur të dënuarin e bartnin nëpër qytet me një karrocë, më pas i pritej koka para turmës së njerëzve dhe në fund trupi i tij bëhej copa-copa. Në disa raste, për të lehtësuar vuajtjet e të dënuarit gjyqtari urdhëronte që para se të digjej në turrën e druve, ai të mbytej nga ana e ekzekutorëve të vendimit. Edhe pse këto mënyra të ekzekutimit synonin të fusnin frikën në tek shtetasit e tjerë me qëllim moskryerjen e veprave penale, në vetvete kjo përbënte një torturë të vërtetë. Përveç parandalimit të përgjithshëm, zbatimi i dënimit synonte të realizonte dhe parandalimin e posaçëm që kishte për synim eliminimin e rrezikshmërisë së të dënuarit.

¹⁰ ¹⁰ V. Parlato, Pietro Leopoldo: Un principe riformatore, në Revistën shkencore Studi Urbinati, Vol.67, Nr. 3-4, Universiteti i Urbino, Urbino, fq. 245.

Në këtë kohë dënimi me burg ishte një torturë në kuptimin e plotë të fjalës, sepse vuajtja e dënimit realizohej në mjedise dhe me mënyra aspak të përshtatshme që të shkaktonin v uajtje të rënda fizike dhe psikike. Përdorimi i burgjeve për dënimin e kryerësve të veprave penale shënon lindjen e sistemit penitenciar dhe problemeve me të cilat ky sistem përballej. Duke qenë se qëllimi kryesor i dënimit ishte lidhur me veçimin e të dënuarve nga shoqëria, problemet e para penitenciare kishin të bë nin me sigurinë dhe policinë e burgjeve.¹¹

Ndër idetë dhe projektet kryesore i cili shërbeu si projekti i parë i një burgu modern, u paraqit përpara Parlamentit anglez nga Jeremy Bentham rreth vitit 1790, i cili si qëllim kishte ndërtimin e një strukture të mirëfilltë penitensiare e quajtur “Panoptikon” ose “Inspection House” për ekzekutimin e dënimit me burgim. I konsideruar si “Panoptikon i Benthamit”, në këtë projekt struktura penitensiare ishte e punuar si një ndërtesë rrethore me qelitë e të burgosurve të vendosura rreth murit të jashtëm dhe të do minuara nga një kullë vëzhgimi.

Në këtë projekt Bentham, kishte hedhur idenë e krijimit të një mekanizmi kontrolli ku izolimi dhe kufizimi i lirisë shoqëroheshin nga vëzhgimi i vuajtjes së të dënuarit. Në bazë të këtij projekti ai zhvilloi teorinë se i burgosuri është subjekt i vëzhgimit dhe si rrjedhojë edhe e pushtetit.¹²

Për herë të parë parime si panopticismi reflektoheshin në një projekt duke i përfshirë të gjitha elementet që shërbejnë si rregulla në institucionet e burgjeve. Pra Benthami ka projektuar procesin e vëzhgimit në një drejtim, që do të thotë që gardianët, rojtarët dhe stafi i burgut dhe vizitorët e burgut të mund të vështrojnë të burgosurit, por të burgosurit mund të shikonin vetëm galerinë e vëzhguesve. Ky ishte në thelb parimi i vëzhgimit qendror se çdo i burgosur duhej të dinte që mund të ishte nën vëzhgim të vazhdueshëm.¹³

¹¹ G. Callandriello, *Ristrette: Una storia minore*, Premiceri editore srls, Padova, 2016, fq. 9.

¹² Z. Alker, *Building Bentham's Panopticon*, 2016, në *Platformen: The digital Panopticon, Tracing London convicts in Britain & Australia*, 1780-1925.

¹³ Ibid.

4.Dënimi me vdekje

Dënimi me vdekje ishte një prej dënimeve më të zakonshme në periudha të ndryshme të historisë. Deri pas përfundimit të Luftës Dytë Botërore, pavarësisht se kishte një konsensus se dënimi me vdekje nuk i shërbente qëllimit të dënimit, shumë vende vazhdonin ta përdornin. Megjithatë ndër studiuesit e parë që e ka hedhur idenë për heqjen e dënimit me vdekje ka qenë Cesare Beccaria, e shprehur kjo në veprën e tij “Krimet dhe ndëshkimet”. Ai i trajtonte dënimet me vdekje dhe dënimet deri në vdekje si dënime shumë të rënda dhe që rrezikonin të binin ndesh me ndalimin e torturës dhe trajtimit jonjerëzor apo degradues. Mizoria e ndëshkimeve në shek. XVIII, shpeshherë çonte në abuzime dhe dënime jo konsekuente, kështu p.sh. për një vjedhje të vogël, një fshatar dënohej me vdekje. Për më shumë, trupi i të dënuarit shpesh gjymtohej dhe shpërndahej në pika të ndryshme të qytetit. Një problem tjetër ishte se të dënuarve me vdekje zakonisht u merrej pasuria, gjë që ndëshkonte dhe linte të gjithë familjen e tij pa të ardhura.¹⁴

Me bindjet humaniste dhe si ndjekës i teorisë së kontratës shoqërore, Beccaria ishte kundër këtij sistemi. Ai ishte i bindur se duhej të ekzistonte një proporcion midis krimeve dhe dënimeve, dhe ky duhet të ishte një faktor i integruar i sistemit të drejtësisë penale. Çdo dënim që e tejkalon minimumin e dënimit për të parandaluar në të ardhmen të dënuarin nga kryerja e veprës penale, do të ishte një ndëshkim tiranik dhe arbitrar. Ai ishte një opozitar i fortë i dënimit me vdekje, sepse sipas tij askush nuk do të ishte i gatshëm ta vinte jetën e tij në duart e Sovranit ose të Shtetit ndërsa pranonte kontratën shoqërore. Në veprën e tij ai shprehej: “Unë pyes se çfarë të drejte kanë njerëzit për të prerë fytin e njerëzve të tjerë? Padyshim, jo të drejtën mbi të cilën bazohen sovraniteti dhe ligjet. Ligjet (...) janë vetëm shuma e pjesëve më të vogla të lirisë private të secilit individ dhe përfaqësojnë vullnetin e përgjithshëm, i cili është rezultati i vullnetit të lirë të secilit individ. A i dha kush ndonjëherë të tjerëve të drejtën e heqjes së jetës së tij?”.

Sipas Beccarias, jeta konsiderohej e mira më e madhe dhe s’mund të sakrifikohej për një pjesë të vogël të lirisë së secilit. Ndërkohë, ai argumenton për heqjen e dënimit me vdekje edhe me ligjin e asaj kohe në të cilin ishte e ndaluar vetëvrasja (ndonëse ky ishte një

¹⁴ T. Buracchi, Origini ed evoluzione del carcere moderno, në Revistën ADIR – L’altro diritto (Revistë on-line), 2004, fq.22.

ligj i ndikuar nga kisha), por sipas tij, dënimi me vdekje nuk përputhej me ligjin dhe normën ku vetëvraska nuk ishte as e lejuar dhe as e pranuar në shoqëri. Në këtë mënyrë ai përdorte po një argument të kishës për të vënë në pah një dënim që sipas tij jo vetëm është i padrejtë, por nëse jeta e njeriut nuk konsiderohet si e drejta e tij për të mos ta jetuar, atëherë s'mund të jetë as në duart e njerëzve të tjerë. Për më shumë, ai përmendte një sërë arsyes pse dënimi me vdekje nuk është i dobishëm për shoqërinë. Argumenti i tij parësor për shfuqizimin ose aplikimin e dënimit me vdekje bazohej në teorinë e dobishmërisë, duke konsideruar se një person është më i vlefshëm për shoqërinë nëse vuan një dënim të përjetshëm, por duke i dhënë mbrapsht shoqërisë atë që i ka marrë, sesa kur jeta e tij merret. Megjithatë, Beccaria konsideron se në raste speciale kur jeta e një personi vë në rrezik shtetin dhe të mirën e përbashkët, dënimi me vdekje është i zbatuar, kjo jo si dënim i drejtësisë, por si një luftë kundër kriminelit.¹⁵

Edhe sipas Andrea Pugiotto, për të dyja dënimet i dënuari do të jetojë me ankthin e vdekjes në “krahët e vdekjes” gjatë gjithë kohës dhe ky fakt përbën cenim të dinjitetit njerëzor që mbrohet pothuajse nga të gjitha tekstet kushtetuese.¹⁶ Qëndrimi në “krahët e vdekjes” ndikon në psikologjinë të dënuarit duke shkaktuar sindromën e “death row”, e cila ka të bëjë me stresin traumatik që i shkaktohet një të dënuari me vdekje i cili qëndron në dhoma të veçanta të burgut në pritje të ekzekutimit të dënimit. “Korridori i vdekjes” (death row phenomenon) i njohur ndryshe si rrugëtimi në të cilin gjendet një i dënuar nga momenti i shpalljes së dënimit me vdekje deri në momentin e ekzekutimit të dënimit, është shoqëruar me diskutime të ndryshme në tërësi, duke u konsideruar si një torturë ndaj personit deri në vdekjen e tij. Ky itinerar është i gjatë dhe kompleks dhe përfshin kryerjen e një sërë veprimesh si ankime, zhvillim të procedurës përpara Gjykatës së Apelit dhe Gjykatës së Lartë apo edhe kërkesë për falje dënimi. Pritja është e gjatë dhe i dënuari qëndron ndërkohë në izolim pa ditur asgjë rreth fatit të tij, derisa të marrë vesh përfundimisht për datën e ekzekutimit të dënimit ose të daljes nga burgu. “Korridori i vdekjes” është përshkruar si korridori

¹⁵ S. Schiavo, Cesare Beccaria, la tortura e i “romani legislatori”, në *Diritto@Storia*, Rivista internazionale di scienze giuridiche e Tradizione Romana (Revistë on-line), XV, Nr.14, 2016, fq. 5-27.

¹⁶ A. Pugiotto, Pena di morte e dignità umana, Relacion për konferencën me të njëjtin emër “Pena di morte e dignità umana” të mbajtur në Universitetin e Milanos, Milano, 14 qershor 2018, në: <http://www.lifeimprisonment.eu/media/PDF/pugiotto%20pena%20di%20morte.pdf>.

i torturës më së shumti pasi personi ndaj të cilit do të ekzekutohet dënimi me vdekje nuk ka asnjë dijeni për ditën e ekzekutimit.¹⁷

Pavarësisht evoluimit të mbrojtjes së të drejtës së jetës deri në ditët tona, të cilën do ta trajtojmë edhe në kapitujt më poshtë, dënimi me vdekje vijon të zbatohet. Sipas Amnesty International, në fund të vitit 2017 të paktën 21.919 persona janë dënuar me vdekje në botë. Ajo çfarë është shqetësuese akoma më tepër është mënyra e trajtimit të këtyre të dënuarve si aspak e barabartë me kategoritë e tjera të të dënuarve, edhe pse si rregull trajtimi i tyre duhet të jetë në përputhje me të drejtat e njeriut.¹⁸

Një problem i madh është edhe qëndrimi në “Korridorin e vdekjes” të personave të mitur. Irani është shteti i vetëm në botë që zbaton dënimin me vdekje edhe ndaj të miturve. Nga viti 2005 deri në vitin 2018, aty janë ekzekutuar 90 të mitur dhe qëndrojnë në “Korridorin e vdekjes” edhe 80 të mitur të tjerë. Sipas një studimi të bërë nga Qendra për të Drejta Kushtetuese në shtetin e Kalifornisë, vuajtjet për shkak të pritjes së ekzekutimit të një dënimi me vdekje janë njohur si “torturë psikologjike” nga Gjykata Supreme e Kalifornisë e cila theksoi se kushtet e mbajtjes në burg janë shumë të këqija për të burgosurit e “Korridorit të vdekjes” në San Quentin, të cilët detyrohen të jetojnë në kushte të tilla për një kohë të gjatë, ndërsa presin avokatët me qëllim që të ndjekin rrugën ligjore deri në përfundim të gjyqimit.¹⁹

¹⁷A. Panebianco, *Le doux supplice: La sentenza capitale nel diritto internazionale, Il caso degli Stati Uniti*, Tezë diplome në Histori të Institucioneve Sociale dhe Politikave Evropiane, Universiteti i Bolonjës, 2014, fq. 142.

¹⁸Në SHBA, Japoni, Pakistan dhe Vietnam, të dënuarit me vdekje mbahen në izolim për pothuajse gjithë ditën. Mungesa e ushqimit në Indonezi bën që gardianët e burgut t’u kërkojnë para familjarëve me qëllim që t’u japin ushqim të afërmeve të tyre. Në Bjellorusi mungon ndihma mjekësore dhe të dënuarit me vdekje ashtu sikurse në Japoni, Nigeri, Zimbabve qëndrojnë shpesh në kafaz pranë dhomave të errëta ku mund të dëgjojnë edhe ulërimat e të dënuarve të tjerë në momentin e ekzekutimit. Amnesty International, *Pena di morte e condizioni di detenzione, il tema di giornata Mondiale*, 2018, shih: <https://www.amnesty.it/pena-morte-condizioni-detenzione-tema-della-giornata-mondiale/>.

¹⁹International Federation for Human Rights and Center for Constitutional Rights (FIDH / CCR), *Discrimination, Torture, and Execution: A Human Rights Analysis of the Death Penalty in California and Louisiana*, Nr. 618a, 2013, fq. 26.

KAPITULLI II

TORTURA DHE TRAJTIMET ÇNJERËZORE E DEGRADUESE NË VËSHTRIM TË AKTEVE NDËRKOMBËTARE

1.Kuptimi i torturës dhe trajtimeve çnjerëzore sipas Konventës kundër Torturës dhe Trajtimeve a Dënimeve të Tjera Mizore, Çnjerëzore ose Poshtëruese

Konventa kundër Torturës dhe Trajtimeve apo Dënimeve të Tjera Mizore, çnjerëzore apo degraduese e njohur si Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Torturës (U.N.C.A.T) është miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara më datë 10 dhjetor 1984 dhe ka hyrë në fuqi më datë 26 qershor 1987.²⁰

Kjo Konventë përbën traktatin e parë ndërkombëtar që është përpjekur të përcaktojë nocionin e torturës. Sipas nenit 1 të saj, torturë quhet çdo veprim me anën e së cilit një personi i janë shkaktuar me dashje dhimbje ose vuajtje të rënda fizike ose psikike, me synimin për të marrë informata apo pohime, për ta ndëshkuar për një veprim që ai ka kryer ose dyshohet se e ka kryer, për të frikësuar apo për të bërë presion, ose për çdo motiv tjetër, kur vuajtjet e tilla shkaktohen nga një person zyrtar ose nga një person i tretë që vepron sipas detyrës zyrtare apo me nxitjen a pëlqimin e tij.²¹ Ndalimi i torturës, dënimit apo trajtimit mizor, çnjerëzor apo degradues në Konventën e O.K.B-së kundër torturës ka një karakter absolut. Natyra absolute e ndalimit të torturës, dënimit ose trajtimit mizor, çnjerëzor apo degradues dhe karakteri i paderogueshëm i detyrimeve të shteteve anëtare i japin një status të privilegjuar të cilin e kanë shumë pak të drejta të tjera, si ndalimi i robërisë, tregtisë së skllëvërve, dhe zbatimi retroaktiv i ligjit penal.²² Neni i Konventës, paragrafi 2 e njeh këtë status duke parashikuar se asnjë rrethanë e jashtëzakonshme, e çfarëdo lloji, qoftë në gjendjen e luftës apo kërcënim prej luftës, paqëndrueshmëri e brendshme politike apo çdo gjendje tjetër e jashtëzakonshme, s'mund të shërbejë si shfajësim për torturën.²³

Nga përkufizimi i nocionit të torturës, dallohen karakteristikat bazë të kësaj vepre penale që janë këto: veprimi duhet kryer nga një person zyrtar gjatë periudhës së kryerjes së detyrës, veprimi

²⁰ Data 26 qershor 1987 njihet ndryshe edhe si Dita Ndërkombëtare në Mbështetje të Viktimave të Torturës.

²¹ Konventa kundër Torturës dhe Trajtimeve apo Dënimeve të Tjera Mizore neni 1, <https://www.ohchr.org/en/instruments-mechanisms/instruments/convention-against-torture-and-other-cruel-inhuman-or-degrading>.

²² M. Nowak, vepër e cituar, fq. 154.

²³ Ibid, paragrafi 2.

kryhet me dashje; veprimi i kryer nga personi zyrtar ka për qëllim ta detyrojë personin e dyshuar të nxjerrë informata apo pohime. Në vazhdim të përcaktimit të nocionit të torturës, Konventa parasheh edhe detyrimin e shteteve për të marrë masa efektive ligjore për të parandaluar torturën, si dhe ndalimin e përdorimit të çdo deklarate që është marrë ndërmjet torturës si element I provës në procesin gjyqësor.²⁴

Gjithashtu, Konventa i ndalon vendet që të kthejnë një refugjat në vendin e tij, kur ka arsye që të besojnë se ai do të torturohet dhe kërkon që në marrjen e këtij vendimi, vendet pritëse të marrin parasysh standardet e mbrojtjes së të drejtave të njeriut në vendin e origjinës së personit.

Parashikimet e lartë përmendura zbatohen vetëm për torturën, ndaj një pjesë e doktrinës e sheh të nevojshëm të bëjë dallimin ligjor në mes të torturës dhe dënimeve ose trajtimeve mizore, çnjerëzore ose degraduese në zbatim të kësaj Konvente. Ndërsa autorë të tjerë mendojnë se Konventa nuk ka bërë një dallim të qartë në mes torturës dhe dënimeve ose trajtimeve çnjerëzore ose degraduese, pasi që në thelb Konventa është e interesuar vetëm për eliminimin e torturës. Në këtë mënyrë, shtetet anëtare vendosin vetë që të ndalojnë çfarëdo lloj dënimi apo trajtimi çnjerëzor ose degradues në territoret e tyre duke përcaktuar detyrimin për marrjen e masave për ndalimin e torturës dhe dënimit apo trajtimit çnjerëzor ose degradues.²⁵

Neni 3 i Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër Torturës, mbi bazën e parimit të moskthimit, i njohur ndryshe si parimi “non refoulment”, parashikon detyrimin e shteteve anëtare të Konventës për të mos kthyer, dëbuar apo ekstraduar, pasi që konsiderohet se kjo mund të shkaktojë probleme lidhur me përshtatjen e sistemit të brendshëm juridik të shteteve. Si rrjedhojë, në rast konflikti të normave juridike kombëtare dhe ndërkombëtare, kanë përparësi normat ndërkombëtare mbi ligjet e brendshme të shteteve²⁶. Ky nen e përcakton shprehimisht se në asnjë rrethanë të jashtëzakonshme, madje as kur personi ka kryer një krim të

²⁴ Neni 2, U.N.C.A.T: “Çdo shtet palë merr masa efektive legjislative, administrative, gjyqësore ose masa të tjera për të parandaluar veprimet e torturës në cilindo territor nën juridiksionin e tij. Asnjë rrethanë e jashtëzakonshme e çfarëdo lloji, qoftë gjendje e luftës ose kërcënim nga lufta, paqëndrueshmëri e brendshme politike apo çdo gjendje tjetër e jashtëzakonshme nuk mund të shërbejë si shfajësim për torturën. Urdhri i dhënë nga një epror ose autoritet publik nuk mund të shërbejë si shfajësim për torturën.” Neni 15, U.N.C.A.T: “Çdo shtet palë siguron për çdo deklaratë e cila është provuar të jetë marrë nëpërmjet torturës, të mos përdoret si element prove në një proces, përveç rastit kur ky fakt përdoret kundër personit të akuzuar për torturë për të provuar se është dhënë deklarata.

²⁵ Shih J. Herrmann, Implementing the Prohibition of Torture on Three Levels, vepër e cituar, fq. 300.

²⁶ Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër Torturës neni 3, <https://www.ohchr.org/en/instruments-mechanisms/instruments/convention-against-torture-and-other-cruel-inhuman-or-degrading>.

rëndë, s'mund të përjashtohet nga e drejta e moskthimit për shkak se në vendin e origjinës apo çdo vend tjetër ku do të ekstradohet rrezikon që ti nënshtrohet torturës.²⁷

Neni 4 i Konventës, paragrafi 1 duket sikur i përfshin veprat e tjera penale si veprime torture, por kuptimi i kësaj dispozite është i lidhur ngushtë me nenin 16 të Konventës, i cili e qartëson situatën duke parashikuar detyrimin e çdo shteti anëtar për të parandaluar brenda territorit nën juridiksionin e tij veprime të tjera që përbëjnë dënime apo trajtime mizore, çnjerëzore ose degraduese. Në mënyrë të qartë, ky nen përcakton se detyrimet parandaluese të parashikuara në nenet nga 10 deri në 13 të Konventës vlejnë njëloj si për torturën, ashtu edhe për dënimet apo trajtimet mizore, çnjerëzore ose degraduese.²⁸

Sipas neneve të lartë përmendura, shtetet anëtare kanë detyrimin: të sigurojnë trajnime për zbatimin e ligjit me qëllim të parandalimit të torturës dhe veprimeve të tjera sipas nenit 16 të Konventës; të mbajnë metodat e marrjes në pyetje në shqyrtim; të hetojnë menjëherë çdo pretendim se zyrtarët e tyre kanë kryer tortura gjatë kryerjes së detyrave të tyre zyrtare; të sigurojnë që individët të cilët pretendojnë se dikush ka kryer tortura kundër tyre të lejohen të bëjnë ankesë zyrtare dhe ta hetojnë atë. Nëse ankesa në rastin e fundit është provuar, atëherë individit duhet të marrë kompensimin duke përfshirë trajtimin e plotë mjekësor dhe pagesat për të mbijetuarit, nëse viktimi vdes si rezultat i torturës. Konventa kërkon që të gjitha veprimet që përbëjnë torturë të përfshihen si vepra penale në legjislacionin e brendshëm penal të shteteve dhe ato të japin dënime duke marrë parasysh seriozitetin e tyre. Në varësi të rrethanave, pavarësisht se Konventa kërkon marrjen e masave vetëm brenda juridiksionit të shteteve, kjo nuk do të thotë se u lejohet kryerja e veprave penale të torturës dhe dënimit apo trajtimit çnjerëzor ose degradues jashtë territorit të juridiksionit të tyre. Pavarësisht mungesës së detyrimit të shteteve për marrjen e masave ndaluese, të gjitha shtetet kanë një lloj “detyrimi” të marrin masa ekstraterritoriale që imponojnë dënimin e veprave penale të torturës, dënimit ose trajtimit mizor, çnjerëzor ose degradues.²⁹

²⁷ Shih J. Kidd, *Torture and International Law: A Note on Recent Developments*, në *Revistën The University of Queensland Law Journal*, Vol. 15, Nr.2, 1989, fq. 233.

²⁸ Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Torturës neni 4 <https://www.ohchr.org/en/instruments-mechanisms/instruments/convention-against-torture-and-other-cruel-inhuman-or-degrading>.

²⁹ Shih M. J. Garcia, *U.N.CAT: Overview and Application to Interrogation Techniques*, Congressional Research Service, 2009, fq. 2

Sipas kësaj Konvente, për të kualifikuar torturën, apo trajtimin mizor, çnjerëzor apo degradues, së pari, dhembja ose vuajtja duhet të shkaktohet me veprimin, pëlqimin, nxitjen apo pranimin në heshtje të zyrtarit publik apo nga persona të tjerë që veprojnë në emër të Shtetit. Kjo kërkesë do të thotë që shtetet s'mund të jenë përgjegjëse nëse veprimet e torturës apo trajtimeve çnjerëzore, mizore ose degraduese do të kryhen nga persona jashtë kontrollit ose autoritetit të tyre. Së dyti, shtetet mund të gjenden përgjegjëse për veprimet e torturës apo trajtimeve jonjerëzore, mizore ose degraduese nga individë privatë në territorin e tyre nëse ata dështojnë që të marrin masa të përgjithshme ose specifike për parandalimin e ushtrimit të dhunës prej tyre.

Përveç detyrimit për të hetuar dhe dëshmshpërblyer rastet e torturës ose trajtimit çnjerëzor apo degradues, sipas Konventës të përmendur më lartë dhe Konventës Ndërkombëtare mbi të Drejtat Civile dhe Politike, Shtetet palë kanë detyrimin që të miratojnë dhe zbatojnë legjislacionin që kriminalizon këto vepra. Konkretisht në nenin 4 të Konventës kundër Torturës, Dënimit apo Trajtimit Çnjerëzor apo Degradues sanksionohet se: “1. Çdo shtet palë siguron që të gjitha veprimet e torturës të konsiderohen si vepra penale nga ligjet e tyre penale. E njëjta gjë vlen edhe për tentativën për ushtrimin e torturës dhe për çdo veprim tjetër të kryer nga çdo person si pjesëmarrës në torturë apo në bashkëveprim. 2. Secili shtet palë do të japë dënime përkatëse për këto vepra penale duke marrë parasysh seriozitetin e tyre.”

Për zbatimin e parashikimeve të nenit 4, neni 5 i Konventës parashikon se rastet e vendosjes së juridiksionit nga ana e shteteve anëtare: kur tortura kryhet në cilindo territor brenda juridiksionit të tyre; kur personi i supozuar që ka kryer torturën është shtetas i atij shteti, si edhe kur viktimi është shtetas i atij shteti³⁰. Në pjesën e dytë të Konventës krijohet Mekanizimi Monitorues i Konventës, i cili quhet Komiteti Kundër Torturës dhe përcaktohen rregullat për zbatimin e Konventës. Sipas doktrinës, në aspektin ligjor, efikasiteti i zbatimit të dispozitave të pjesës së dytë të Konventës varet jo aq shumë nga përcaktimet ligjore sesa nga integriteti dhe ndërgjegjja e anëtarëve të Komitetit.³¹ Komiteti ka në përbërje të tij dhjetë ekspertë me integritet të lartë dhe me njohuri të spikatura në fushën e të drejtave të njeriut.

Shtetet anëtare duhet t'i paraqesin Komitetit nëpërmjet Sekretarit të Përgjithshëm të O.K.B.-së raporte plotësuese çdo katër vjet për të gjitha masat e reja që kanë marrë dhe raporte të tjera të

³⁰ Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Torturës neni 5, <https://www.ohchr.org/en/instruments-mechanisms/instruments/convention-against-torture-and-other-cruel-inhuman-or-degrading>

³¹ Kidd, vepër e cituar, fq. 234.

cilat mund ti kërkojë Komiteti. Komiteti shqyrton secilin raport dhe mund të japë vërejtje të përgjithshme të cilat i quan të duhura dhe ia dërgon këto vërejtje shtetit palë përkatës. Nëse Komiteti merr informata të besueshme në bazë të cilave, sipas mendimit të tij, ekzistojnë tregues të bazuar se tortura zbatohet sistematikisht në territorin e ndonjë shteti anëtarë, atëherë Komiteti fton shtetin në fjalë që të bashkëpunojë në shqyrtimin e këtyre informatave dhe të adresojë vërejtjet e tij për këtë çështje. Komiteti u paraqet çdo vit shteteve palë dhe Asamblesë së Përgjithshme të Organizatës së Kombeve të Bashkuara një raport për veprimtaritë që ai ka ndërmarrë në përputhje me këtë Konventë.

Një risi e Konventës së O.K.B.-së kundër Torturës është futja e procedurës së hetimit të parashikuar në nenin 20 të saj. Procedura e hetimit nis nga Komiteti vetëm pasi ka informacione të besueshme se tortura praktikohet sistematikisht në territorin e ndonjë shteti palë. Edhe në rastet kur shteti ka ratifikuar Konventën, duke paraqitur si rezervë mosnjohjen e së drejtës së Komitetit për të ushtruar procedurën e hetimit në përputhje me nenin 28 të Konventës, Komiteti mund të bëjë një hetim për gjetjen e fakteve të tjera në rast se ka një marrëveshje të qartë me shtetin anëtar.³²

Pra, e drejta e hetimit nga ana e Komitetit kufizohet me pranimin nga ana e shteteve palë drejtpërdrejtë me ratifikimin e Konventës pa asnjë rezervë apo kur shtetet heqin dorë nga rezerva dhe pranojnë me marrëveshje hetimin në territorin e vendit të tyre.

Kufizimi i fuqisë së Komitetit për hetimin e mëtejshëm kur dyshohet për torturë të ushtruar në mënyrë sistematike mund të duket se i përmbahet rolit të tij si një Mekanizëm Parandalues, pa fuqi ligjore detyruese, por në fakt është një shprehje e qartë se dobësimi i sovranitetit të shteteve dhe nevoja e supremacisë së normave ndërkombëtare mbi sistemet e brendshme juridike ka qenë një process mjaft i vështirë dhe që ka kaluar në një rrugë të gjatë zhvillimi.³³

³² Nowak, vepër e cituar, fq. 178.

³³ Kidd, vepër e cituar, fq. 234.

2.Obligimet dhe përgjegjësitë që rrjedhin nga Konventa kundër torturës dhe trajtimeve a dënimeve të tjera mizore, çnjerëzore ose poshtëruese për shtetet

Sipas Nenit 2 të kësaj Konvente, secili shtet palë merr masa efektive gjyqësore,legjislative, administrative, ose masa të tjera për të parandaluar veprimet e torturës në cilindo territor nën juridiksionin e tij³⁴.

Sipas paragrafit 2 asnjë rrethanë e jashtëzakonshme, e çfarëdo lloji, qoftë gjendje e luftës ose kërcënim nga lufta, paqëndrueshmëri e brendshme politike apo çdo gjendje tjetër e jashtëzakonshme, nuk mund të shërbejë si shfajësim për torturën.³⁵

Ndërsa sipas paragrafit 3 urdhri i dhënë nga një epror ose autoritet publik nuk mund të shërbejë si shfajësim për torturën.³⁶

Sipas Nenit 3 të kësaj Konvente, asnjë shtet palë nuk do të dëbojë, nuk do të prapësojë, e as nuk do të ekstradojë një person në një shtet tjetër ku ka arsye serioze për të besuar sa ai rrezikon t'i nënshtrohet torturës.³⁷

Neni 4 thotë: secili shtet palë duhet të sigurojë që të gjitha veprimet e torturës të konsiderohen vepra penale nga ligji i tij penal. E njëjta gjë vlen për tentim ushtrimin e torturës dhe për çdo veprim tjetër të kryer nga çdo person si pjesëmarrës në torturë apo në bashkëveprim.³⁸

Secili shtet palë merr masa të tilla të nevojshme për vendosjen e juridiksionit të vet për të gjykuar shkeljet e përmendura në nenin 4, në raste e mëposhtme:

- Kur veprat penale kryhen në cilindo territor nën juridiksionin e vet ose në anije ose aeroplan të regjistruar në atë shtet,
- Kur kryerësi i supozuar është shtetas i atij shteti,
- Kur viktimi është shtetas i atij shteti, në qoftë se ky shtet konsideron se një gjë e tillë është e përshtatshme.³⁹

Çdo shtet anëtarë siguron që arsimi dhe informacioni në lidhje me ndalimin e torturës të jenë pjesë përbërëse e trajnimit të personelit civil ose ushtarak të ngarkuar për zbatimin e ligjeve, të

³⁴ Konventa kundër torturës dhe trajtimeve a dënimeve të tjera mizore, çnjerëzore ose poshtëruese për shtetet neni 2. Linku: <https://www.ohchr.org/en/instruments-mechanisms/instruments/convention-against-torture-and-other-cruel-inhuman-or-degrading> .

³⁵ KKTTDTMÇP, neni 2 paragrafi 2.

³⁶ KKTTDTMÇP, neni 2 paragrafi 3.

³⁷ Ibid, neni 3

³⁸ Ibid, neni 4

³⁹ Ibid, neni 4

personelit mjekësor, të personave zyrtarë dhe të personave të tjerë të cilët mund të marrin pjesë në ruajtjen, marrjen në pyetje ose trajtimin e çdo individi të paraburgosur, të privuar nga liria ose të burgosur në çfarëdo mënyre. Çdo shtet palë përfshin ndalimin e sipërpërmendur në rregullat ose udhëzimet e nxjerra lidhur me detyrimet dhe atributet e personave të tillë.

Gjithashtu secili shtet anëtarë ushtron një mbikëqyrje sistematike të rregullave, metodave, udhëzimeve dhe praktikave të pyetjes dhe të dispozitave lidhur me ruajtjen dhe trajtimin e personave të arrestuar, të privuar nga liria apo të burgosur në çfarëdo mënyre në çdo pikë të territorit nën juridiksionin e tij, me qëllim që të mënjanohet secili rast i torturës.

Sipas nenit 12 secili shtet palë siguron që autoritetet kompetente të fillojnë menjëherë një hetim të paanshëm kurdoherë që ka motive të arsyeshme për të besuar se një veprim i torturës është kryer në çdo pikë të territorit nën juridiksionin e tij.⁴⁰

Sipas nenit 15 secili shtet palë siguron për çdo deklaratë e cila është provuar të jetë marrë nëpërmjet torturës, të mos përdoret si element prove në një proces, përveç rastit kur ky fakt përdoret kundër personit të akuzuar për torturë për të provuar se është dhënë deklarata.⁴¹

Këto janë vetëm disa nga obligimet e shteteve që rrjedhin nga Konventa, sepse ka edhe nene të tjera ku ceket edhe obligimet e tjera si p.sh., neni 8, 9, 11, 13, 14, 16 etj.⁴²

3.Obligimet në ndërlidhje me themelimin e Komitetit kundër torturës

Komiteti kundër torturës parashihet të përbëhet nga dhjetë ekspertë me moral të lartë dhe me një kompetencë të njohur në fushën e të drejtave të njeriut, të cilët marrin pjesë në cilësi vetjake. Ekspertët zgjedhën nga shtetet anëtare duke pasur parasysh një ndarje gjeografike të drejtë dhe interesin e pjesëmarrjes në punimet e Komitetit të personave që kanë një përvojë juridike. Anëtarët e Komitetit zgjedhën me votim të fshehtë nga një listë kandidatësh të caktuar nga shtetet anëtare. Secili shtet palë mund të caktojë një kandidat të zgjedhur nga radhët e shtetasve të tij. Shtetet palë duhet të kenë parasysh interesin që ekziston për të caktuar kandidatët që janë njëkohësisht anëtarë të Komitetit të të Drejtave të Njeriut të krijuar në bazë të Paktit

⁴⁰ Konventa kundër torturës dhe trajtimeve a dënimeve të tjera mizore, çnjerëzore ose poshtëruese për shtetet neni 12. Linku: <https://www.ohchr.org/en/instruments-mechanisms/instruments/convention-against-torture-and-other-cruel-inhuman-or-degrading> .

⁴¹ Ibid, neni 15

⁴² IINKU <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=73754> .

Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike dhe që të kenë vullnet të mirë për të marrë pjesë në Komitetin Kundër Torturës.

Anëtarët e Komitetit zgjedhën në mbledhjet dyvjeçare të shteteve anëtare që i thërret Sekretari i Përgjithshëm i O.K.B. Në këto mbledhje, ku kuorumi përbëhet nga dy të tretat e shteteve palë, anëtarë të Komitetit zgjedhën kandidatët të cilët fitojnë numrin më të madh të votave dhe shumicën absolute të votave të përfaqësuesve të shteteve palë që janë të pranishme dhe që marrin pjesë në votim.⁴³

Anëtarët e Komitetit zgjedhën me një mandat prej katër vitesh dhe ata mund të rizgjedhën po të paraqiten sërish. Megjithatë, mandati i pesë prej anëtarëve të zgjedhur në zgjedhjen e parë merr fund pas dy viteve.⁴⁴

Shtetet palë i paraqesin Komitetit, nëpërmjet Sekretarit të Përgjithshëm të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, raportet në lidhje me masat që kanë marrë për zbatimin e detyrimeve të marra përsipër sipas Konventës kundër torturës dhe trajtimeve a dënimeve të tjera mizore, çnjerëzore ose poshtëruese, brenda një viti pas hyrjes së kësaj Konvente në fuqi për çdo shtet palë të interesuar. Përveç kësaj, shtetet palë paraqesin raporte plotësuese, çdo katër vite, për të gjitha masat e reja që kanë marrë, dhe raporte të tjera të cilat mund t'i kërkojë Komiteti. Sekretari i Përgjithshëm i Organizatës së Kombeve të Bashkuara ua dërgon raportet të gjitha shteteve anëtare. Komiteti shqyrton çdo raport dhe mund të japë vërejtje të atilla të përgjithshme të cilat i quan të duhura dhe ia dërgon këto vërejtje shtetit palë përkatës. Çdo shtet palë mund t'ia dërgojë Komitetit, si përgjigje, të gjitha vërejtjet që i konsideron të nevojshme.

Sipas nenit 21 të Konventës kundër torturës dhe trajtimeve a dënimeve të tjera mizore çnjerëzore ose poshtëruese:

- a) Në qoftë se një shtet palë konsideron se një shtet tjetër palë nuk i zbaton dispozitat e kësaj Konvente, ai mund t'ia tërheq vëmendjen këtij shteti, me një njoftim me shkrim, lidhur me këtë çështje. Brenda tre muajve nga data e marrjes së njoftimit shteti të cilit i është dërguar njoftimi do t'ia dërgojë shtetit nga i cili ka marrë njoftimin shpjegime ose çdo deklaratë tjetër me shkrim për sqarimin e çështjes, të cilat përfshijnë për aq sa

⁴³ Konventa kundër torturës dhe trajtimeve a dënimeve të tjera mizore, çnjerëzore ose poshtëruese për shtetet neni 17.Linku: <https://www.ohchr.org/en/instruments-mechanisms/instruments/convention-against-torture-and-other-cruel-inhuman-or-degrading> .

⁴⁴ KKTTÇD, neni 17 paragrafi 5.

- është e mundur dhe e dobishme, të dhëna për rregullat e procedurës dhe për mjetet juridike qoftë të përdorura më parë, qoftë në vazhdim, qoftë ende të hapura.
- b) Në qoftë se brenda gjashtë muajve, pas marrjes së njoftimit të parë nga shteti të cilit i është dërguar, çështja nuk është rregulluar asisoj që të kënaqë të dyja shtetet palë të interesuara, si njëri ashtu edhe tjetri do të kenë të drejtë për t'ia shtruar Komitetit, duke i dërguar një notë si Komitetit ashtu edhe shtetit tjetër të interesuar.
 - c) Komiteti mund të shqyrtojë një çështje, sipas këtij neni, vetëm pasi të jetë siguruar se janë përdorur dhe shtruar të gjitha mjetet juridike të brendshme të mundshme, në përputhje me parimet e së drejtës ndërkombëtare, të njohura përgjithësisht. Ky rregull nuk zbatohet në rastet kur procedurat sipas mjeteve juridike i kalojnë afatet e arsyeshme, dhe as në rastet kur gjasat janë të vogla që këto procedura të kënaqin personin i cili është viktimë e shkeljes së kësaj Konvente;
 - d) Komiteti mban mbledhje me dyer të mbyllura kur shqyrton informacionet e parapara me këtë nen;
 - e) Në përputhje me dispozitat e nënparagrafit (c), Komiteti u vë në dispozicion shërbimet e tij të mira shteteve palë të interesuara, me qëllim që të arrihet një zgjidhje pajtimi të çështjes mbi bazën e respektimit të detyrimeve të parapara me këtë Konventë. Për këtë qëllim, Komiteti, po qe se mendon se është e dëshirueshme, mund të kërkojë formimin e një komisioni ad hoc të pajtimit;
 - f) Në çdo çështje që i është parashtruar, sipas këtij neni, Komiteti mund t'u kërkojë shteteve palë të interesuara, që përmenden në nënparagrafin (b), që t'i japin çdo informacion përkatës lidhur me këtë çështje.
 - g) Shtetet palë të interesuara, që përmenden në nënparagrafin (b), kanë të drejtë të përfaqësohen gjatë shqyrtimit të çështjes nga Komiteti si dhe t'i paraqesin vërejtjet e tyre me shkrim ose me gojë, në një formë a në një tjetër.
 - h) Komiteti paraqet një raport brenda dymbëdhjetë muajve pas datës kur ka marrë njoftimin siç përmendet në nënparagrafin (b): (i) Në qoftë se është arritur një zgjidhje në përputhje me dispozitat e nënparagrafit (d), Komiteti kufizon raportin e vet me një paraqitje të shkurtër të fakteve dhe të zgjidhjes së arritur;
 - i) Në qoftë se nuk është arritur ndonjë zgjidhje në përputhje me dispozitat e nënparagrafit (d), Komiteti e kufizon raportin e vet me një paraqitje të shkurtër të

fakteve: teksti dhe procesverbali i vërejtjeve të paraqitura gojarisht nga shtetet palë të interesuara i bashkëngjiten raportit. Për çdo çështje, raporti u komunikohet shteteve palë të interesuara.⁴⁵

4.Tortura dhe trajtimet çnjerëzore e degraduese sipas Konventës Evropiane për të Drejtat e njeriut

Ndalimi i torturës dhe i dënimeve apo trajtimeve çnjerëzore ose degraduese është një normë ndërkombëtare e përgjithshme, e cila edhe pse është e formuluar në mënyra të ndryshme, haset në instrumente të ndryshme ndërkombëtare, sikurse është neni 3 i Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Megjithatë, u konsiderua e nevojshme marrja e masave më efikase ndërkombëtare, kryesisht në mbrojtjen dhe respektimin e dinjitetit dhe të drejtave të personave të privuar nga liria. Mekanizmat e mbrojtjes të të drejtave të ngritura nga K.E.D.NJ. kishin sjellë rezultate të rëndësishme. Me qëllim të forcimit të masave të parashikuara nga kjo Konventë për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, Asambleja Këshillimore e Këshillit të Europës miratoi Rekomandimin 971/1983 lidhur me mbrojtjen e personave të privuar nga liria kundër torturës dhe trajtimeve ose dënimeve mizore, çnjerëzore ose degraduese.⁴⁶ Në këtë tekst, Asambleja i rekomandonte Komitetit të Ministrave në veçanti miratimin e projektit të krijimit të Konventës Evropiane mbi mbrojtjen e personave të privuar nga liria kundër torturës dhe trajtimeve apo dënimeve mizore, çnjerëzore ose degraduese. Komiteti i Ministrave e ka miratuar tekstin e Konventës më 26 qershor 1987, e cila u hap në të njëjtën datë për nënshkrim nga shtetet palë të Këshillit të Europës. Më pas u miratuan dy Protokolle Shtesë të cilat kanë hyrë në fuqi më 1 mars 2002. Pas miratimit të K.E.D.NJ.-së, Konventa Evropiane për Parandalimin e Torturës dhe Dënimeve apo Trajtimeve Çnjerëzore ose Degraduese konsiderohet gjerësisht si një nga traktatet më të rëndësishme të Këshillit të Evropës. Ajo është ratifikuar nga të gjitha shtetet palë të Këshillit të Evropës dhe ratifikimi i Konventës ka qenë si parakusht për të gjitha shtetet që i janë bashkuar Këshillit të Evropës në vitet e fundit.

⁴⁵ KKTTCQD, neni 21

⁴⁶ Parliamentary Assembly, Recommendation 971 (1983), shih linkun: <http://www.assembly.coe.int/nw/xml/XRef/Xref-XML2HTML-en.asp?fileid=15005&lang=en>.

Konventa nuk ofron përkufizime të torturës dhe formave tjera të keqtrajtimit, pasi qëllimi i saj kryesor ishte krijimi i Komitetit për Parandalimin e Torturës dhe Dënimeve apo Trajtimeve jonjerëzore apo Degraduese (K.P.T.). Nisur nga emërtimi i mësipërm mund të nxjerrim në dukje dy tipare të rëndësishme të K.P.T.-së: së pari, është një organ evropian dhe së dyti, mbulon jo vetëm “torturën”, por dhe një gamë të gjerë të situatave të cilat mund të çojnë në “trajtim ose dënim çnjerëzor apo degradues”. K.P.T. ka të drejtë që të vizitojë çdo vend që i përket juridiksionit të shteteve nënshkruese (anëtarëve), ku gjenden personat e privuar nga liria si pasojë e një veprimi të autoriteti publik, duke pasur si qëllim që të kontrollojë trajtimin e personave të privuar nga liria në ambientet e policisë, të paraburgimit dhe në burgje, si dhe të nxisë bashkëpunimin e shtetit përkatës që të përmirësojë kushtet e qëndrimit dhe trajtimin e personave që janë privuar nga liria. Në lidhje me nenin 3 të K.E.D.NJ.-së, jurisprudenca e G.J.E.D.NJ.-së dhe Komisioni Evropian i të Drejtave të Njeriut ofrojnë një guidë për Komitetin, i cili ka për detyrë që të orientojë aktivitetet e tij nga parandalimi dhe jo nga zbatimi i kërkesave juridike në situata të caktuara. K.P.T. nuk duhet të kërkojë të ndërhyjë në interpretimin dhe zbatimin e nenit 3 të K.E.D.NJ.-së.⁴⁷

Vizitat e K.P.T.-së mund të bëhen në çfarëdo rrethane, dhe Konventa zbatohet jo vetëm në kohë të paqes, por edhe në kohë lufte ose në rast të çdo rreziku tjetër publik. Vizitat mund të organizohen në çdo lloj vendi ku gjenden për çdo lloj motivi persona të privuar nga liria. Konventa zbatohet në vendet ku personat mbahen në paraburgim të përkohshëm, të burgosur pasi janë gjetur fajtorë për shkelje, që mbahen në ndalim administrativ ose të internuar për arsye mjekësore ose në vendet ku të miturit mbahen nga një autoritet publik. Ajo zbatohet dhe në rastet e arrestimit nga autoritete ushtarake.⁴⁸

K.P.T. mund të organizojë vizita periodike si dhe vizita ad hoc. Në rast se do të veprojë me efikasitet, për sa u përket vizitave periodike, Komiteti duhet të marrë parasysh domosdoshmërisht numrin e vendeve për të vizituar në shtetet e interesuara, si dhe duhet të kujdeset për të vizituar shtete të ndryshme në mënyrë periodike. Komiteti duhet t’u japë

⁴⁷ Sipas nenit 1 të Konventës Evropiane për Parandalimin e Torturës, “krijohet një Komitet Evropian për Parandalimin e Torturës dhe Dënimeve ose Trajtimeve Çnjerëzore ose Poshtëruese (i quajtur tani e tutje “Komiteti”). Me anë të vizitave, Komiteti shqyrton trajtimin e personave të privuar nga liria duke synuar, në rast se nevojitet, forcimin e mbrojtjes së tyre kundër torturës dhe dënimeve ose trajtimeve çnjerëzore ose poshtëruese”.

⁴⁸ Sipas nenit 2 të Konventës Evropiane për Parandalimin e Torturës, “çdo Palë autorizon vizitën, në përputhje me këtë Konventë, të çdo vendi që ndodhet nën juridiksionin e saj, ku individëve u është hequr liria nga një autoritet publik”.

një lloj prioriteti vizitave ad hoc që do t'i duken të nevojshme nga rrethanat.¹⁰⁸ Kjo do të thotë se në programin e vizitave periodike të K.P.T.-së nuk duhet të synohen të gjitha vendet ku personat janë të privuar nga liria.

Sipas T.Surlane, krijimi i dy mekanizmave GJ.E.D.NJ. dhe K.P.T. përbën një marrëveshje rajonale të Këshillit të Evropës për të siguruar një mbrojtje të dyfishtë në parandalimin e torturës dhe formave të keqtrajtimit. Të dy këto mekanizma luajnë rol të rëndësishëm në përcaktimin e nocioneve dhe realizimin e diferencimit ndërmjet torturës dhe dënimeve apo trajtimeve çnjerëzore ose degraduese.⁴⁹

5.Tortura dhe trajtimet çnjerëzore e degraduese sipas praktikës së Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut nuk u mjaftua vetëm me shpalljen e të drejtave dhe lirive por u kujdes që të siguronte respektimin e detyrimeve të ndërmarra nga shtetet që e kanë firmosur, duke krijuar tre mekanizmat për zbatimin e saj: Komisionin Evropian të të Drejtave të Njeriut,⁵⁰ Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut dhe Komitetin e Ministrave të Këshillit të Evropës. GJ.E.D.NJ. u krijua në vitin 1959 me zgjedhjen e gjyqtarëve të parë nga ana e Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës. Gjykata përbëhet nga shumë gjyqtarë, po aq sa janë edhe shtetet anëtare të K.E.D.NJ.-së, të cilët zgjidhen mbi bazën e listave të përbëra nga 3 kandidatë të cilët propozohen nga secili shtet anëtar. Gjyqtarët qëndrojnë në detyrë për nëntë vjet dhe mandati i tyre nuk është i rinovueshëm. Anëtarët e Gjykatës zgjedhin mes tyre një President dhe dy Zëvendës presidentë për një periudhë kohore tre-vjeçare që mund të rinovohet.⁵¹

Si një nga mekanizmat më të rëndësishëm për mbrojtjen dhe garantimin e të drejtave të njeriut, Gjykata e Strasburgut u jep mundësinë personave dhe shteteve që pretendojnë shkeljen e të drejtave të paraqiten përpara saj dhe të kërkojnë mbrojtjen e të drejtave të tyre.

⁴⁹ T. Surlan, Prohibition of torture: absolute or relative?, në Revistën Shkencore “Bezbednost”, Nr. 3, Belgrade, 2016, fq. 10.

⁵⁰ Protokoli Nr. 11 që hyri në fuqi më 1 nëntor 1998 zëvendësoi Gjykatën ekzistuese që punonte me orar të pjesshëm, si dhe Komisionin me një Gjykatë të vetme që punonte me orar të plotë. Për më shumë shih A. Anastasi, E drejta Kushtetuese, Shtëpia botuese Pegi, Tiranë, 2004, fq. 76.

⁵¹ Shih O. Muçollari, Të drejtat ndërkombëtare të njeriut, Shtëpia botuese Mirgeeralb, Tiranë, 2015, fq. 76.

Gjykata shqyrton çështjen vetëm pasi janë shteruar të gjitha mjetet e brendshme ligjore dhe kur kanë kaluar të paktën 6 muaj nga vendimi i formës së prerë. Objekt i shqyrtimit të saj janë: ankesat e shteteve palë ndaj njëri-tjetrit dhe kërkesat individuale nga çdo individ, organizatë joqeveritare ose grup individësh që pretendojnë për shkelje të të drejtave të njohura nga K.E.D.NJ. nga një prej shteteve anëtarë të Konventës.⁵²

Njashtu, Gjykata jep mendime këshilluese të arsyetuara, me kërkesën e Komitetit të Ministrave, për çështje ligjore që lidhen me interpretimin e Konventës dhe të protokolleve të saj. Në asnjë mënyrë mendimet këshilluese nuk trajtojnë çështje që kanë të bëjnë me përmbajtjen dhe shtrirjen e të drejtave dhe lirive të përcaktuara në Konventë apo çështje të paraqitura në Gjykatë ose Komitetin e Ministrave si ankesë ndaj një shkelje të pretenduar. Mekanizmi detyrues i Konventës e parashikon zbatimin e vendimit të Gjykatës duke detyruar palët që ti përmbahen vendimit të formës së prerë i cili i përcillet Komitetit të Ministrave për ekzekutim. Sekretariati i Përgjithshëm mund të kërkojë nga palët të arsyetojnë rreth mënyrës mbi të cilën legjislacioni i brendshëm e siguron zbatimin efektiv të neneve të Konventës dhe të protokolleve të saj.⁵³

Nëpërmjet vendimeve që i kanë dhënë zgjidhje shkeljeve të të drejtave të qytetarëve të shteteve palë, GJ.E.D.NJ. ka pasur një rol të rëndësishëm në transformimin e të drejtave nëpërmjet ndryshimeve në ligjet e këtyre vendeve, si dhe ka shërbyer si një burim referimi nga gjykatat e shteteve në vendimmarrjet e tyre. Gjykata ka pësuar transformime vazhdimisht në mënyrën e organizimit, por njëkohësisht dhe në procesin e gjykimit me qëllim që të reduktohet koha e shqyrtimit pranë kësaj gjykate të një numri shumë të lartë aplikimesh nga shtetas të vendeve të ndryshme, anëtarë të K.E.D.NJ.-së.

⁵² Sipas nenit 34 K.E.D.NJ., Gjykata mund të marrë kërkesat nga çdo person, organizatë joqeveritare ose grup individësh që pretendojnë të jenë viktimat të një shkeljeje nga një prej Palëve të Larta Kontraktuese të të drejtave të parashtruara në Konventë ose në protokollin e saj. Palët e Larta Kontraktuese zotohen të mos pengojnë në ndonjë mënyrë ushtrimin efektiv të kësaj të drejte.

⁵³ Neni 52 K.E.D.NJ.: Çdo Palë e Lartë Kontraktuese, me kërkesë të Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës, jep shpjegim mbi mënyrën se si e drejta e saj e brendshme siguron zbatimin efektiv të të gjitha dispozitave të Konventës.

6. Analiza e nenit 3 të K.E.D.NJ.-së sipas jurisprudencës së GJ.E.D.NJ.-së

K.E.D.NJ. i ka dhënë një rëndësi të madhe ndalimit të torturës dhe formave të tjera të trajtimit çnjerëzor ose degradues. Neni 3 i Konventës përbën një parim themelor, i cili së bashku me të drejtën për të jetuar garanton mbrojtjen e dinjitetit njerëzor si njëren prej vlerat themelore të shoqërisë evropiane dhe përcakton standardet për zbatimin e të drejtave të njeriut. Këtë përcaktim e gjejmë për herë të parë të shprehur në jurisprudencën e GJ.E.D.NJ.-së në çështjen *Soreing kundër Mbretërisë së Bashkuar*⁵⁴ ku Gjykata shprehet se ndalimi absolut i torturës sipas kushteve të Konventës tregon se neni 3 i K.E.D.NJ.-së paraqet një nga vlerat themelore të shoqërive demokratike që përbëjnë Këshillin e Evropës. Ajo gjithashtu duhet të gjendet në terma të ngjashëm në instrumente të tjera ndërkombëtare sikurse është Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike të vitit 1966 dhe Konventa Amerikane për të Drejtat e Njeriut të vitit 1969 dhe përgjithësisht njihet si një standard i pranuar ndërkombëtarisht.

Detyrimet e parashikuara në nenin 3 të K.E.D.NJ.-së, në të drejtën ndërkombëtare janë erga omnes, pavarësisht se e shtrijnë efektin e tyre në një grup relativisht të kufizuar të kombeve duke qenë të detyrueshme vetëm për shtetet e Këshillit të Evropës. Megjithatë, jehona e vendimeve të GJ.E.D.NJ.-së kalon çdo kufi shtetëror dhe përbën ius cogens në hierarkinë e normave të së drejtës ndërkombëtare.⁵⁵ Karakteristikë e nenit 3 të K.E.D.NJ.-së është karakteri absolut që i jep ndalimit të torturës dhe formave të tjera të trajtimit çnjerëzor ose degradues. Sipas një pjese të doktrinës, karakteri absolut i dispozitës për ndalimin e torturës dhe formave të trajtimit çnjerëzor apo degradues⁵⁶ del qartë nga praktika duke e analizuar ndalimin e parashikuar në nenin 3 të K.E.D.NJ.-së në lidhje me paragrafin 2, të nenit 15 të kësaj Konvente, i cili e përcakton torturën si një të drejtë absolute të paderogueshme e cila nuk mund të kufizohet dhe prej së cilës nuk lejohen përjashtime asnjëherë, madje as në kohë luftë apo emergjencash publike që kërcënojnë sigurinë e një shteti.

⁵⁴ Vendimi I Gj.E.D.NJ.-së, datë 07.07.1989, *Soreing kundër Mbretërisë së Bashkuar* (kërkesa nr.14038/88).

⁵⁵ Në lidhje me këtë argument shih Vendim i Gj.E.D.NJ.-së, datë 21.11.2001, *Al -Adsani kundër Mbretërisë së Bashkuar*. Po kështu shih edhe Asambleja e Përgjithshme e O.K.B.-së: Rezoluta 61/153, datë 19.12.2006; Rezoluta 62/148, 18.12.2007. Gjithashtu e të njëjtit mendimi është edhe Gjykata Penale Ndërkombëtare për ish-Jugosllavinë në Vendimin datë 10.12.1998, Prokurori kundër Anto Furundzija, & 153-157.

⁵⁶ Shih M. K. Addo, N. Grief, Does Article 3 of The European Convention on Human Rights Enshrine Absolute Rights, në *Revistën shkencore European Journal of International Law*, Vol. 9, Nr. 3, 1998, fq. 513.

Ky karakter absolut vjen edhe nga pikëpamja morale se tortura është një akt barbar në kundërshtim me parimet themelore që mbrojnë jetën dhe respektojnë dinjitetin njerëzor⁵⁷ dhe se shkelja e kësaj dispozite bart një angazhim serioz, jo vetëm në mbrojtje të së drejtës individuale, por gjithashtu edhe për rendin publik të Evropës në tërësi. Pavarësisht debateve dhe interpretimeve të autorëve të ndryshëm të doktrinës mbi karakterin absolut të ndalimit të torturës dhe formave të trajtimit çnjerëzor ose degradues, vlerësojmë se është e rëndësishme të fokusohemi në analizën e interpretimit dhe evoluimit që i ka bërë ndër vite Gjykata e Strasburgut me vendimet e saj.

Sipas kësaj jurisprudence e cila ka mbetur pothuajse e njëjtë për një periudhë të gjatë kohore, neni 3 i K.E.D.NJ.-së ruan një nga vlerat më themelore të një shoqërie demokratike nëpërmjet ndalimit absolut pavarësisht nga rrethanat apo sjellja e viktimës. Si pasojë e karakterit absolut të ndalimit të torturës, rrjedh pamundësia për të pranuar përjashtime ose kufizime në lidhje me të drejta të tjera themelore apo nevoja të ligjshme të shteteve. Në lidhje me këtë pikë jurisprudence e Strasburgut ka marrë në konsideratë disa raste duke mos pranuar si justifikim të ligjshëm nevojën për të parandaluar kryerjen e veprave penale në çështjen Tyrer kundër Mbretërisë së Bashkuar, nuk është pranuar si justifikim i ligjshëm as nevoja për të shpëtuar jetën e të tjerëve, kjo e parashikuar në vendimin Gäfgen kundër Gjermanisë; nuk është pranuar si justifikim i ligjshëm nevoja për të garantuar sigurinë publike kundër aktivitetit të personave të rrezikshëm, deklaruar kjo nga G.J.E.D.NJ. në vendimet El-Masri kundër Maqedonisë; Saadi kundër Italisë; Ramirez Sanchez kundër Francës, etj. Edhe në rrethanat e luftës ose të çdo emergjence publike që kërcënon jetën e një kombi, ndalimi i torturës dhe trajtimeve çnjerëzore përbën një detyrim thelbësor për shtetet palë të Konventës në respekt të vlerave themelore të demokracive evropiane.⁵⁸

Gjatë analizës të jurisprudence të G.J.E.D.NJ.-së është vënë re se kjo e fundit e ka theksuar në mënyrë të vazhdueshme ndalimin në terma absolutë të torturës dhe dënimeve ose trajtimeve çnjerëzore apo degraduese edhe në rrethana shumë të vështira, të tilla si

⁵⁷ Y. Shany, The Prohibition Against Torture and Cruel, Inhuman, and Degrading Treatment and Punishment: Can the Absolute Be Relativized Under Existing International Law?, në *Revistën shkencore Catholic University Law Review*, Vol.56, Issue3, 2007, fq. 843.

⁵⁸ Vendim i G.J.E.D.NJ.-së, datë 31.05.2018, Abu Zubaydah kundër Lituanisë (kërkesa nr. 46454/11 & 629); Vendim i G.J.E.D.NJ.-së, datë 31.05.2018, Al Nashiri kundër Rumanisë (kërkesa nr. 33234/12 & 665); Vendim i G.J.E.D.NJ.-së, datë 30.10.2018, O.R. dhe L.R. kundër Moldavisë (kërkesa nr. 24129/11 & 55); Vendim i G.J.E.D.NJ.-së, datë 30.05.2017, Grecu kundër Moldavisë (kërkesa nr. 51099/10 & 17); Vendim i G.J.E.D.NJ.-së, datë 16.11.2017, Boukroukrou dhe të tjerët kundër Francës (kërkesa nr. 30059/15 & 77).

lufta kundër krimit të organizuar dhe terrorizmit. Vështirësia objektive për të menaxhuar një situatë emergjente është mbajtur parasysh në vlerësimin e bërë nga Gjykata, me qëllim për të mundësuar një përcaktim sa më të saktë të përgjegjësisë së shteteve.

Pavarësisht këtyre parashikimeve, G.J.E.D.NJ. nuk e ka konsideruar shkelje me nenin 3 të Konventës aplikimin e formave të privimit të lirisë personale në periudha të gjata kohe, që në vetvete përbëjnë kufizim të lirive dhe të drejtave të njeriut, por ka vendosur kushtin për kryerjen e kontroleve të shpeshta të motiveve të sigurisë që e justifikojnë zbatimin e këtyre mënyrave, ashtu sikurse mund të përmendim rastet e zbatimit të regjimit të posaçëm të parashikuar nga neni 41-bis i legjislacionit italian apo kufizimin e vazhdueshëm të lirisë personale për të sëmuret e rrezikshëm mendor.

Jurisprudenca e Gjykatës i jep një rëndësi të posaçme karakterit absolut jo vetëm të torturës, por edhe të trajtimit ose ndëshkimit çnjerëzor dhe degradues duke mos e paraqitur të ndarë rëndësinë e këtyre koncepteve nga njëri-tjetri dhe duke i konsideruar të të njëjtin nivel rëndësie për mbrojtjen nga shkelja, pavarësisht përcaktimeve të ndryshme që i kanë. Neni 3 i Konventës, sipas të cilit askush nuk duhet t'i nënshtrohet torturës apo dënimeve dhe trajtimeve çnjerëzore e degraduese, bart një formulim që në dukje është i përgjithshëm dhe nuk jep një përkufizim të qartë të torturës dhe formave të trajtimit çnjerëzor. Nëpërmjet interpretimit të vendimeve, Gjykata e Strasburgut ka dhënë ndihmën e saj në përkufizimin e torturës dhe ndëshkimit apo trajtimit jonjerëzor e degradues. Jurisprudenca e kësaj Gjykate, në bazë të shkallës së ashpërsisë së veprimit, ka përcaktuar tri koncepte që janë të ndaluara nga neni 3 i K.E.D.NJ.-së, konkretisht torturën, trajtimin apo ndëshkimin çnjerëzor dhe trajtimin ose ndëshkimin degradues. E ashtuquajtura “Çështja Greke” e vitit 1969 si një çështje ndërshtetërore e Danimarkës, Francës, Norvegjisë, Suedisë dhe Holandës kundër Greqisë, ishte rasti i parë që kontribuoi në përcaktimin e këtyre koncepteve si të ndara nga njëra tjetra. Për të dalluar këto koncepte prej njëri-tjetrit, jurisprudenca e Gjykatës së Strasburgut e ka përkufizuar torturën si çdo trajtim jonjerëzor i qëllimshëm, që shkakton vuajtje shumë serioze dhe mizore dhe që si qëllim ka marrjen e informacionit më anë të ndëshkimit dhe frikësimit të viktimës. Ndërsa trajtimi çnjerëzor është përkufizuar si trajtim i qëllimshëm, i ripërsëritur që shkakton vuajtje të rënda, mendore ose fizike, e cila, në një situatë të veçantë, është e pajustificueshme, ndërsa trajtimi degradues është konsideruar si trajtim që ngjall tek individit ndjenjën e ankthit, frikës dhe inferioritetit për ta poshtëruar rëndë

para të tjerëve e për ta thyer rezistencën e tij fizike apo morale ose kur trajtimi e nxit individin të veprojë kundër vullnetit apo ndërgjegjes së tij.⁵⁹

Gjykata e Strasburgut me jurisprudencën e saj ka pranuar se ekziston një përcaktim prej tri nivelesh: për atë vepër që do të konsiderohet trajtim degradues do të duhej të plotësohet pragu minimal i ashpërsisë, më pas për veprat që do të konsiderohen si trajtim jonjerëzor do të duhet të plotësohet pragu i ndërmjetëm dhe nëse do të bëhet fjalë për torturë, do të duhej të plotësohen kushtet e një niveli më të lartë ashpërsie. Jurisprudenca e Gjykatës së Strasburgut ka arsyetuar se vlerësimi i nivelit të ashpërsisë së keqtrajtimit varet nga të gjitha rrethanat e rastit, si: kohëzgjatja e trajtimit jonjerëzor, pasojat fizike ose psikike dhe në disa raste edhe nga gjinia, mosha dhe gjendja shëndetësore e viktimës.

Faktorë të tjerë që mund të përfshihen janë: motivimi me të cilën lidhet kryerja e trajtimit jonjerëzor si dhe konteksti i përgjithshëm i atmosferës së tensioneve dhe emocioneve të larta që shkaktojnë torturë dhe trajtime çnjerëzore.

Megjithatë, nëse shikohen vendimet e dhëna nga GJ.E.D.NJ., shohim se jo gjithmonë Gjykata bën një përkufizim të qartë, duke bërë që të mos vihet re lehtësisht një dallim në mes torturës dhe trajtimit jonjerëzor. Jurisprudenca ndër vite ka ndryshuar dhe për këtë arsye çfarë mund të konsiderohej dikur si trajtim çnjerëzor, tani mund të konsiderohet torturë, pasi edhe vetë cilësimet e veprave janë detajuar më shumë nga praktika. Ky zhvillim i praktikës është në vetvete një nga cilësitë më efikase të kontrollit të Gjykatës ndër vite pasi vetë Konventa është gjithnjë në një proces evolutiv në raport me zhvillimet shoqërore, dhe është cilësuar shpesh si një instrument i gjallë i mbrojtjes së të drejtave të njeriut.

Qëllimi i karakterit absolut të torturës, ndaj së cilës nuk lejohet asnjë kufizim është pikërisht të vendosë balancat, duke shërbyer si një mjet me anë të cilit shtetet limitohen të përdorin derogimin në rastet e situatave emergjente ose krizave, me qëllim respektimin e dinjitetit të individit si interesi më i lartë në respektim të vlerave evropiane. Megjithatë, sipas kësaj pjese të doktrinës në interpretimin që u ka bërë vendimeve të dhëna, GJ.E.D.NJ. është përpjekur që të vendosë një balancë midis së drejtës së individit për t'u mbrojtur nga tortura dhe format çnjerëzore të keqtrajtimit dhe zbatimit dhe vlerësimit të parashikuar të legjislacionit të brendshëm të shteteve anëtare në rastet e situatave të

⁵⁹ Vendim i GJ.E.D.NJ.-së, datë 10.07.2018, Abdulkadyrov dhe Dakhtayev kundër Rusisë (kërkesa nr. 35061/04 & 69).

vështira si lufta kundër terrorizmit. Gjykata ka argumentuar se shtetet kanë mundësi të vlerësojnë më mirë kushtet e ngjarjeve të ndodhura dhe pasojat e ardhura prej tyre, si dhe shkallën e cenimit të dinjitetit njerëzor nga ana tjetër. Jurisprudenca e Gjykatës së Strasburgut nënvizon se Konventa është një instrument për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe se është e një rëndësie vendimtare që ajo të interpretohet dhe zbatohet në një mënyrë që i bën këto të drejta praktike dhe efektive dhe jo thjesht teorike e iluzive.⁶⁰

Nga ana tjetër, shikojmë se në raste të tjera kur shteti ka përdorur forma të trajtimit jonjerëzor në kuadër të luftës kundër terrorizmit, por të cilat nuk kanë sjellë pasoja të jashtëzakonshme mbi shtetin e paditur, GJ.E.D.NJ. ka mbajtur një tjetër qëndrim duke i konsideruar si raste të torturës.⁶¹ Mund të vihet re një rast tipik në vendimin Hajrullahu kundër ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë⁶², ku kërkuesi ishte rrëmbyer dhe mbajtur për tri ditë në një ambient, në kushte plotësisht të papërshtatshme paraburgimi, të organizuar dhe ekzekutuar fshehurazi nga forcat e policisë, duke e vendosur kërkuesin në kushtet e një shqetësimi të madh emocional dhe mendor për shkak të pasigurisë për fatin e tij. Gjithashtu keqtrajtimi gjatë marrjes në pyetje i kishte shkaktuar vuajtje të madhe fizike, ankth, frikë dhe vuajtje mendore. Për shkak se veprimet e mësipërme ishin ushtruar në mënyrë të kombinuar me njëra tjetrën dhe kishin pasur si qëllim rrëfimin e incidentit të shpërthimit të bombës në korrik të vitit 2005, Gjykata e Strasburgut e konsideronte një masë të tillë dhune si torturë në shkelje të nenit 3 të Konventës. Nga analiza e vendimeve të Gjykatës së Strasburgut, arrijmë në përfundimin se tortura përbën një trajtim të një mizorie të veçantë, i cili shkakton qëllimisht një vuajtje të veçantë me qëllimin për të marrë informata, për të ndëshkuar ose për të frikësuar viktimën. Një sjellje e jashtëligjshme që nuk arrin nivelin e mizorisë së torturës ose nuk kryhet për qëllimet për të cilat kryhet tortura përbën trajtim çnjerëzor. Nga ky përkufizim, nuk del në mënyrë të qartë dallimi midis të dyja rasteve dhe për këtë arsye, çështja duhet parë rast pas rasti duke mbajtur parasysh faktin se në përcaktimin

⁶⁰ Cullen, vepër e cituar, fq. 42; Gross, vepër e cituar, fq. 635-636.

⁶¹ Vendim i GJ.E.D.NJ.-së, datë 10.07.2018, Abdulkadyrov dhe Dakhtayev kundër Rusisë (kërkesa Nr.35061/04 & 24, 71); Vendim i GJ.E.D.NJ.-së, datë 01.06.2017, Mindadze dhe Nemisitsverdize kundër Gjeorgjisë (kërkesa Nr. 21571/05 & 109); Vendim i GJ.E.D.NJ.-së, datë 07.04.2015, Cestaro kundër Italisë (kërkesa Nr. 6884/11 & 236); Vendim i GJ.E.D.NJ.-së, datë 13.12.2012, El -Masri kundër Republikës ish-Jugosllave të Maqedonisë (kërkesa Nr., 39630/09).

⁶² Vendim i GJ.E.D.NJ.-së, datë 29.10.2015, Hajrullahu kundër ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë, (kërkesa nr. 37537/07).

hierarkik tortura është shkalla më e lartë e dhunës që ndalohet nga neni 3 i K.E.D.NJ.-së, duke u ndjekur nga trajtimi çnjerëzor e më pas ai degradues.

Shumica e rasteve të paraqitura përpara GJ.E.D.NJ.-së në shkelje të nenit 3 të K.E.D.NJ.-së kanë pasur natyrën e trajtimit çnjerëzor apo degradues, kjo për shkak se tërësia e elementeve të kërkuara për të qenë torturë shpeshherë nuk ka qenë e plotë. Kryesisht çështjet e lidhura me dhunën e pajustificuar ushtruar nga funksionarët publikë në zbatim të ligjit apo në tejkalim të tij janë konsideruar si trajtim jonjerëzor. Kështu, sipas një vendimi të Gjykatës së Strasburgut, rrahja nga forcat e policisë, e bërë përgjatë një periudhe të shkurtër tensioni, është konsideruar si sjellje që nuk përbën torturë për shkak të mungesës së elementeve rënduese, të cilat i kemi përmendur më sipër, duke përmendur këtu qëllimin për nxjerrjen e informacionit. Ndryshe nga tortura, elementet çnjerëzore dhe degraduese nuk kërkojnë domosdoshmërisht karakterin e qëllimshëm të sjelljes apo efektet e tij. Rastet më të shpeshta të vendimeve të dhëna nga Gjykata e Strasburgut për trajtim jonjerëzor dhe degradues lidhen kryesisht me kushtet e burgjeve dhe vihet re se elementet çnjerëzore ose degraduese mund të rezultojnë nga veprime ose rrethana që nuk ushtrohen anë mënyrë aktive nga vetë individët drejtpërsëdrejti, por që vijnë në formën e neglizhencës ose edhe të kushteve të pandryshueshme.⁶³ Megjithatë, kjo nuk e përjashton përgjegjësinë e vendeve duke e konsideruar faktin se shkelja e nenit 3 të K.E.D.NJ.-së mund të shkaktohet edhe duke mos vepruar. Në secilin rast, shtetet anëtare të Konventës janë vazhdimisht të vëzhguara nga instrumente si K.P.T.-ja për të siguruar kushtet dhe standardet e nevojshme për të mos e cenuar mbrojtjen e të drejtave të parashikuara në K.E.D.NJ.

Përkufizimet mbi këto vepra janë parë gjithmonë si relativisht të ndryshueshme në kohë, për sa kohë që dhe vetë Konventa duhet parë si një instrument i gjallë ligjor, i cili ndryshon në interpretimin e tij në funksion të dinamikës së jetës. Si rrjedhojë, mund të themi se ajo çfarë para shumë vitesh në kontekstin e Konventës mund të konsiderohej si trajtim degradues ose çnjerëzor, me zhvillimin e shoqërisë njerëzore sot përgjithësisht mund të konsiderohet torturë. Në çdo rast, këto standarde minimum do të shihen gjithnjë në raport me zhvillimet shoqërore për t'iu përgjigjur në mënyrën më të mirë funksionit të tyre, mbrojtjes së individit në çdo kohë

⁶³ Vendim i GJ.E.D.NJ.-së, datë 15.01.2019, Ilgiz Khalikov kundër Rusisë (kërkesa Nr. 48724/15 & 38); Vendim i GJ.E.D.NJ.-së, datë 19.01.2017, Singh dhe të tjerët kundër Greqisë (kërkesa Nr. 60041/13 & 58).

KAPITULLI III

TORTURA DHE TRAJTIMET ÇNJERËZORE E DEGRADUESE NË ASPEKTIN KRAHASUES KOSOVË - SHQIPËRI

1. Tortura dhe trajtimeve çnjërëzore sipas Kodit Penal të Kosovës

Edhe pse Kosova nuk është anëtare e Këshillit të Evropës dhe Gjykata e Strasburgut nuk ka juridiksion mbi të, vendi jonë edhe për shkak edhe të historisë së hidhur në luftërat e fundit në Ballkan, e garanton të drejtën e jetës dhe ndalon dënimin me vdekje dhe të torturës e trajtimit çnjërëzor e degradues në Kushtetutën tonë.⁶⁴

Dispozitat e Kodit Penal e parashohin torturën si veprë penale të posaçme. Në nenin 196 të KPK parashihet se personi zyrtar ose personi i cili duke vepruar nën ndikimin apo me pëlqimin ose pranimin e heshtur të personit zyrtar kryen aktin e torturës, dënohet me burgim nga një deri në pesëmbëdhjetë vjet burg.⁶⁵

Kur vepra penale, e parashikuar nga paragrafi i parë i këtij neni kryhet ndaj fëmijës, kryerësi dënohet me burgim nga tre deri në pesëmbëdhjetë vjet burg.⁶⁶

Kosova me Kodin Penal të saj i ndalon dhe ndëshkon edhe të gjitha ato veprime të cilat rezultojnë me trajtim çnjërëzor të një personi, trajtim që rezulton me shkaktim të vuajtjeve të mëdha, lëndimeve të rënda të trupit ose të shëndetit fizik apo mendor. Edhe në këto raste është fjala për personin i cili ndodhet në pozitë varësie. Ato manifestojnë shtrirje të shumë vepra penale, por kryesisht të veprat penale kundër të drejtës ndërkombëtare.

1.1. Kuptimi i torturës dhe trajtimeve çnjërëzore

Kodi Penal i Kosovës në kuadër të përkufizimeve përkatëse që i bën e specifikon kuptimin e torturës. “Sipas këtij përkufizimi me shprehjen “torturë” duhet nënkuptuar shkaktimin e qëllimshëm të dhembjes apo vuajtjes së rëndë fizike apo mendore mbi një person i cili është në

⁶⁴ Neni 27 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës: 1. Secili individ gëzon të drejtën për jetën. 2. Dënimi me vdekje është i ndaluar. Neni 27 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës: Askush nuk i nënshtrohet torturës, ndëshkimit a trajtimit mizor, çnjërëzor ose poshtëruës.

⁶⁵ Kodi Penal i Republikës së Kosovës nr. 06/L-074, neni 196.

⁶⁶ KPK, neni 196 paragrafi 2.

ndalim ose është nën kontrollin e kryesit; përjashtimisht, tortura nuk përfshin dhembjen apo vuajtjen karakteristike apo të pandarë që rezultojn nga sanksionet e ligjshme.”⁶⁷

Si do qoftë, një përkufizim më të mirë të torturës e bën shkenca e të drejtës penale. Në këtë këndvështrim tortura përkufizohet si “Një akt ç’njerëzor, poshtërues e degradues, e ndërmarr nga personi zyrtar, një veprim i kryer me dashje, me qëllim që nga ai person të merren informata, ose pohime të ndryshme për veprime të cilat i ka kryer apo dyshohet se i ka kryer.”⁶⁸

Për dallim prej torturës, në raport me sjelljen çnjerëzore nuk ndeshet ndajë specifikim i detajuar i shprehjes sjellje çnjerëzore. Megjithatë në kuptimin teorik, me shprehjen “Sjellje çnjerëzore duhet nënkuptuar veprimet e egra, të pamëshirshme e mizore të cilat “inter alia” kryhen me paramendim, për një periudhë kohe të caktuar, si edhe që shkaktojnë lëndime trupore ose vuajtje intensive fizike a mendore të ndonjë personi që është në pozitë varësie.”⁶⁹

Akti i torturës nënkupton kryerjen ose moskryerjen e një akti me anë të të cilit me dashje personit i shkaktohet dhimbja ose vuajtja e rëndë, qoftë fizike ose psikike, me qëllim të marrjes së informatës apo deklaratës nga personi i tillë ose nga personi i tretë, apo me qëllim të dënimit të personit të tillë për një vepër të cilën ai ose personi i tretë e ka kryer ose dyshohet se e ka kryer, ose për frikësimin apo shtrëngimin e personit ose të personit të tretë për arsye që kanë të bëjnë me diskriminim të çfarëdo lloji. Akti i torturës nuk përfshin asnjë veprim ose mosveprim që rrjedh vetëm nga aktet e pashmangshme apo karakteristike të sanksioneve të ligjshme.⁷⁰ Siç shihet tortura mund të kryhet vetëm nga një subjekt i posaçëm domethënë personi që ushtron funksione publike, i cili vepron me dashje me qëllim të marrjes së informacioneve. Akti i torturës mund të kryhet me veprim ose mosveprim dhe dhimbja që i shkaktohet tjetrit mund të jetë qoftë fizike ose psikike. Kjo vepër mund të kryhet vetëm me dashje të drejtpërdrejtë.

Nga neni 196 i KPK del se subjekt i veprës penale të torturës është vetëm personi që ushtron funksione publike, i cili duhet t’i përdorë këto cilësi në kryerjen e veprës penale, por edhe vepra penale që kryhet duhet të kërkojë përdorimin e këtyre cilësive.

⁶⁷ KPK, neni 149, paragrafi 2.5.

⁶⁸ F. Imeri, S. Sheremeti, Nocioni i torturës, Juridica, Instituti Gjyqësor i Kosovës, fq. 53. Linku: <http://jus.igjk.rks-gov.net/678/1/Tortura%20Shqip.pdf>.

⁶⁹ Ndalimi i Torturës, Trajtimet dhe Dënimet Çnjerëzor ose Poshtërues, Guidë mbi jurisprudencën e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, Civil Rights Defenders, 2018, fq. 12. Linku: https://rolplatform.org/ep-content/uploads/2019/02/rol_prohibition_against_torture-alb.pdf.

⁷⁰ KPK, neni 196 paragrafi 3.

Tortura rregullohet edhe në aspektin kushtetues ku neni 27 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës thotë se: Askush nuk i nënshtrohet torturës, ndëshkimit a trajtimit mizor, çnjerëzor ose poshtërues.

Kjo dispozitë përbëhet nga tri elemente kryesore ‘torturë’, ‘çnjerëzor’, ‘poshtërues’, kuptimi i së cilave së bashku me pasojat që ato shkaktojnë përcaktojnë se cilat veprime bien ndesh me këtë nen.

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut në nenin 3 të saj thotë se: Askush nuk duhet të i nënshtrohet torturës ose trajtimit ose dënimit çnjerëzor ose poshtërues.⁷¹

Dënimi me burgim të përjetshëm si dënimi më i rëndë, në mesin e sanksioneve penale të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, ka gjetur vend në këtë të fundit pas abrogimit të dënimit me vdekje me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2000/59 neni 1⁷², pika 1.5 dhe 1.6 duke zëvendësuar kështu dënimin me burgim afatgjatë të përcaktuar sipas KPK. Tani dënimi me burgim të përjetshëm parashihet në 36 vepra penale të ndryshme duke përfshirë por jo dhe kufizuar në vepra penale si tradhtia ndaj vendit, gjenocidi, vrasja e rënde dhe krimet kundër njerëzimit. Shqiptimi i këtij sanksioni kërkon që vepra penale të jetë e rëndë dhe e kryer në rrethana rënduese apo që kjo vepër penale. Ky dënim është shqiptuar nga gjykatat në Republikën e Kosovës 8 herë në periudhën 2019-2023. mirëpo nuk ka arritur formën e prerë.

Instituti bashkëkohor i drejtësisë penale i lirimit me kusht ofron shpresë për lirim nga burgimi i përjetshëm. Në përputhje me nenin 90 të KPK sigurohet mundësia e lirimit me kusht për personin e dënuar me burgim të përjetshëm pasi që të ketë mbajtur 30 vite nga ky dënim.⁷³

Mundësia e rishikimit të dënimit, për lirim me kusht në bazë të legjislacionit Kosovar është në përputhje me standardin e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, përkatësisht nenin 3 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Sipas GJ.E.D.NJ, rishikimi është e vetmja mënyrë për të vlerësuar dhe rivlerësuar siç duhet bazën legjitime penologjike që justifikon dënimin e shqiptuar me burgim të përjetshëm, duke i lënë në kompetencë gjykatave kombëtare të përcaktojnë formën dhe kohën e këtij rishikimi.

⁷¹ KEDNJ, neni 3.

⁷² Linku: https://unmik.unmissions.org/sites/default/files/regulations/03albanian/A2000regs/RA2000_59.htm.

⁷³ KPK, neni 90.

1.2.Elementet përbërëse të torturës dhe trajtimeve çnjerëzore

Si çdo vepër penale tjetër edhe tortura përbëhet nga disa elemente të posaçme të cilat atë e bëjnë vepër penale specifike. Rrjedhimisht, nisur nga përkufizimi ligjor rezulton se elemente të veprës penale të torturës konsiderohen:

- a) Dhuna.- Në rastin e veprës penale të torturës dhuna ushtrohet kundër një personi tjetër me qëllimin që nga ai ose personi i tretë të merret informata me qëllim të dënimit të personit të tillë.
- b) Subjekti që e ushtron dhunën.- Te vepra penale e torturës dhunën e ushtron personi zyrtar, apo personi tjetër që vepron nën ndikimin, me pëlqimin apo pranimin e heshtur të tij.
- c) Forma e fajësisë.- Kjo vepër penale mund të kryhet vetëm me dashje, dhe atë me dy format e dashjes- dashjen direkte dhe dashjen eventuale.
- d) Subjekti pasiv.- Subjekt pasiv të vepra penale e torturës mund të jetë çdo person i akuzuar për një vepër penale për të cilën pretendohet ta ketë kryer, dhe kjo me qëllimin që përmes dhunës të arrihet deri te dënimi i tij.

Rrjedhimisht, edhe trajtimet çnjerëzore sajohen pothuaj nga elemente të ngjashme me torturën, por specifike përbën fakti se:

- a) Dhuna.-Këtu dhuna korrespondon në sjellje çnjerëzore që në vete ngërthejnë veprime të egra, të pamëshirshme e mizore që drejtohen ndaj ndonjë personi që gjendet në pozitë varësie, që mund të rrjedhin p.sh., edhe për shkak të përkatësisë së tij kombëtare.
- b) Kohëzgjatja e dhunës.- Dhuna manifeston shtrirje në një periudhë kohe të caktuar, dhe ajo konsiston në shkaktim të vuajtjeve fizike e shpirtërore.

1.3.Karakteristikat e torturës dhe trajtimeve çnjerëzore

Vepra penale e torturës manifeston këto karakteristika:

- a) Kryerës i kësaj vepre penale mund të jetë vetëm personi zyrtar apo personi tjetër që venpron nën ndikimin, me pëlqimin apo pranimin e heshtur të tij.

- b) Viktimë e kësaj vepre penale mund të jetë çdo person ndaj të cilit zhvillohet një proces gjyqësor, dhe qëllimi i torturës ka të bëjë me marrje të informatës që do të mundësonte ndjekjen penale apo dënimin e tij.
- c) Akti i torturës nënkupton kryerjen ose moskryerjen e një akti me anë të të cilit me dashje personit i shkaktohet dhembja apo vuajtja e rëndë, qoftë fizike ose mendore, me qëllim të marrjes së informatës apo deklaratës nga personi i tillë ose nga personi i tretë, ose me qëllim dënimin e personit të tillë për një vepër të cilën ai ose personi i tretë e ka kryer ose dyshohet se e ka kryer, ose për frikësimin apo shtrëngimin e personit ose të personit të tretë për arsye që kanë të bëjnë me diskriminim të çfarëdo lloji.
- d) Dënimi i parashikuar për kryerësin e kësaj vepre penale është nga një deri në 15 vjet burgim. Se çfarë mase dënimi do t'i shqiptohet kryerësit varet nga rrethanat nën të cilat është kryer vepra dhe pasojat që ajo i ka shkaktuar.

Rrjedhimisht, edhe në rastin e trajtimeve çnjerëzore, ligjdhënësi e kanos kryerësin, varësisht shtrirjes së saj me dënim me burgim nga një deri në pesëmbëdhjetë vjet, di dhe dënimin me burgim të përjetshëm, në rastet kur i akuzuari akuzohet për kryerje të veprës penale të krimeve kundër njerëzimit.⁷⁴

2.Tortura dhe trajtimet çnjerëzore sipas Kodit Penal të Shqipërisë

Në legjislacionin e brendshëm të Republikës së Shqipërisë, vepra penale “Tortura” së bashku me veprën penale të “Torturës me pasoja të rënda” janë parashikuar në Kreun II të Kodit Penal, të titulluar “Vepra penale kundër personit” dhe në mënyrë konkrete në Seksionin III, të titulluar “Vepra penale të kryera me dashje kundër shëndetit”. Sipas teorisë së të drejtës, me qëllim që të kemi konfigurimin e një vepre penale është e rëndësishme ekzistenca e njëkohshme e katër elementeve përbërëse të veprës penale: objekt, anë objektive, subjekt dhe anë subjektive. Provueshmëria e elementeve objektive dhe subjektive të figurës së veprës penale shërben si bazë për të vënë një person përpara përgjegjësisë penale. Nëse nuk ekziston ose nuk provohet qoftë edhe njëri prej këtyre elementeve ligjore, personi nuk mund të merret nën përgjegjësi penale dhe rrjedhimisht as edhe të dënohet.

⁷⁴ KPK, neni 149, paragrafi 2.8, neni 150, paragrafi 2.2 etj.

Trajtimet çnjerëzore si veprime kriminale, si në rastin e Kosovës, edhe në Republikën e Shqipërisë i hasim me shtrirje të një visteri i veprave penale, por me një përqendrim të krimet kundër njerëzimit dhe krimet e luftës. Në kuadër të këtyre veprave penale, trajtimet çnjerëzore konsiderohen veprime kriminale që konsistojnë në shkaktim të vuajtjeve mizore fizike e mendore që kryhen për motive politike, ideologjike, etnike, fetare etj.

2.1.Kuptimi i torturës dhe trajtimeve çnjerëzore

Sipas përkufizimit që e jep Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë “Tortura konsiston në ndërmarrjen e veprimeve, nëpërmjet të cilave një personi i janë shkaktuar vuajtje të rënda, fizike apo mendore, nga një person, që ushtron funksione publike, ose me nxitjen apo miratimin e tij, të hapur ose të heshtur, me qëllim: a) për të marrë prej tij ose një tjetri informacione ose pohime; b) për ta ndëshkuar për një veprim të kryer ose që dyshohet të jetë kryer prej/ose një personi tjetër; c) për ta frikësuar ose bërë presion mbi të ose një person tjetër; ç) për çdo qëllim tjetër të bazuar në çfarëdolloj forme diskriminimi.”⁷⁵

Sipas teorisë së të drejtës penale të Shqipërisë tortura është vepër penale që konsiston në shkaktimin e vuajtjeve fizike e mendore ndaj personit që akuzohet për kryerje të veprës penale, me qëllim të pranimi të përgjegjësisë për te, dhe që ushtrohet nga personi që ushtron funksione publike, gjegjësisht person që vepron me nxitjen apo miratimin e tij të hapur apo të heshtur.

Në anën tjetër, ndonëse me shtrirje të shumë vepra penale, trajtimet çnjerëzore konsiderohen veprime kriminale që konsistojnë në shkaktim të vuajtjeve mizore fizike e mendore që kryhen kryesisht për motive politike, ideologjike, etnike, fetare etj., dhe kjo ka të bëjë kryesisht me veprat penale të krimeve kundër njerëzimit dhe krimet e luftës.

⁷⁵ KPRSH, neni 86.

2.2.Elementet përbërëse të torturës dhe trajtimeve çnjerëzore

Sipas Prof. Dr. Ismet Elezi, objekt i kësaj vepre penale s'është vetëm mbrojtja e shëndetit, por njashu edhe mbrojtja e dinjitetit të personit që u nënshtrohet veprimeve të dhunshme të torturës.⁷⁶ Sipas O. Vangjeli, e drejta për dinjitet, së bashku me të drejtën për jetë përkufizohen si të drejta bazë, të cilat janë burim i të gjitha të drejtave të tjera të njeriut. Në qendër të të gjitha të drejtave të njeriut është e drejta për të jetë duke bërë një jetë plotë dinjitet.⁷⁷

Sipas mendimit tonë, kjo vepër merr në mbrojtje jo vetëm shëndetin dhe dinjitetin e personit, por edhe funksionimin e rregullt të sistemit të drejtësisë në të gjitha ato raste kur kryhet me qëllim për të marrë rrëfimin e subjektit pasiv rreth dijenisë së tij për kryerjen e një vepre penale. Parë në këtë këndvështrim të fundit, mund të thuhet se vepra penale e torturës merr në mbrojtje edhe funksionimin e rregullt të administratës shtetërore, pjesë e së cilës është edhe funksionari publik. Në përfundim të kësaj analize të objektit të veprës penale të torturës, arrijmë në përfundim se kemi të bëjmë me një krim që ka një objekt të shumëfishtë, pavarësisht se ligjvënësi ka preferuar ta vendosë në seksionin e veprave penale të kryera me dashje kundër shëndetit. Sa i përket anës objektive të kryerjes së kësaj vepre penale, ajo kryhet me anë të veprimeve të dhunshme ose nxitjes dhe miratimit për kryerjen e tyre. Në këtë mënyrë, ligjvënësi ka preferuar që në rastin konkret, të mos e përcaktojë në mënyrë të detajuar sjelljen e jashtëligjshme që duhet ndëshkuar duke e lënë të hapur për të përfshirë çfarëdo lloj akti të dhunshëm nëpërmjet të cilit një personi i janë shkaktuar vuajtje të rënda, fizike apo mendore. Mund të përmendim këtu disa nga sjelljet që mund të përbëjnë torturë: rrahjet barbare, përdhunimi, mbyllja e një personi në një dhomë të akullt apo të nxehtë, fikjet e duhanit në lëkurë, lënia pa bukë dhe pa ujë, zhytja e kokës nën ujë, izolimi në një dhomë të errët, varja e personit kokë-poshtë të lidhur nga këmbët për një kohë të gjatë, çarja e mishit dhe mbushja me kripë, përdorimi i elektroshokut, mosdhënia e ilaçeve apo moskryerja e terapive shëruese.

⁷⁶ I. Elezi, E drejta penale: pjesa e posaçme, Botimet Erik, Tiranë, 2008, fq. 80.

⁷⁷ Shih O. Vangjeli, E drejta për dinjitet njerëzor, trajtimi i të burgosurve sipas legjislacionit shqiptar dhe atij ndërkombëtar, në Konferencën shkencore kombëtare "Mekanizmat mbrojtës të të drejtave të individëve në kuadër të procesit të rregullt ligjor", Departamenti i të drejtës publike, Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Tiranës, Botimet Pegi, Tiranë, 2012, fq. 212-219.

Për dallim nga veprat e tjera penale, tortura ka intensitet më të lartë të vuajtjeve që i shkakton. Kjo e dallon edhe nga veprat e tjera penale kundër shëndetit. Vlen të theksohet këtu se ligjvënësi i dënon vetëm ato veprime të jashtëligjshme që shkaktojnë torturë duke mos ndëshkuar shprehimisht me anë të këtij neni veprimet e tjera që mund të jenë trajtim çnjerëzor apo degradues.

Një element i rëndësishëm i cilësimit juridik të kësaj vepre penale është ana subjektive e saj. Sipas mendimit tonë, kjo vepër penale kryhet me dashje të drejtpërdrejtë dhe me qëllim të veçantë. Sipas nenit 86⁷⁸, shkronja “a” të Kodit Penal, kjo vepër kryhet për të marrë nga subjekti pasiv të saj ose një tjetri informacione ose pohime. Në këtë rast, tortura kërkon të ndëshkojë ato sjellje të jashtëligjshme që tentojnë të marrin informacione, për shembull, nga i pandehuri ose nga dëshmitari me qëllimin e zgjidhjes së procesit penal. Mund të flasim në këtë rast për ndëshkimin e asaj forme torture që quhet tortura gjyqësore.

Neni 86, shkronja “b” parasheh ndëshkimin e torturës. Edhe ky rast përbën ndëshkimin e një prej formave më të hershme të shfaqjes së krimit të torturës, atëherë kur ajo përdorej për të ndëshkuar një person për veprimin e kryer ose që dyshohej të jetë kryer⁷⁹. Rasti i tretë i parashikuar nga shkronja “c” e nenit 86 të Kodit Penal ndëshkon torturën e bërë me qëllim të frikësimit të subjektit pasiv të veprës penale apo për të bërë presion mbi të ose një person tjetër. Ky paragraf mund të lidhet edhe me parashikimet e shkronjës “a” të shqyrtuar më sipër, por mund të bëhet edhe për raste të ndryshme nga tortura gjyqësore: për shembull, oficeri i policisë ushtron dhunë ndaj një individi për ta frikësuar që të mos tregojë atë që ka parë⁸⁰. Rasti i katërt, i parashikuar nga shkronja “ç” e nenit 86 të Kodit penal ndëshkon torturën e kryer për çdo qëllim tjetër të bazuar në çfarëdolloj forme diskriminimi. Fjala është kur një person në funksione publike ushtron dhunë ndaj dikujt për motive që lidhen me cilësi të caktuara të subjektit pasiv: për shembull, torturon dikë për shkak të ngjyrës, bindjeve politike, të moshës, apo të çdo lloj forme tjetër diskriminimi⁸¹. Qëllimi për të cilin kryhet vepra penale e parashikuar nga neni 86 i Kodit Penal, parashikuar nga shkronja “d” nuk është shumë e qartë. Në vlerësimin tonë, në këtë rast ligjvënësi ka dashur të ndëshkojë të gjitha aktet

⁷⁸ KPRSH, neni 86.

⁷⁹ KPRSH, neni 86 shkronja b.

⁸⁰ KPRSH, neni 86 shkronja c.

⁸¹ KPRSH, neni 86 shkronja ç.

çnjerezore apo poshtëruese të kryera për çfarëdolloj qëllimi. Ky orientim, edhe pse nuk është shprehur qartë, lë të kuptohet që me anë të këtij neni ndëshkohet jo vetëm tortura, por gjithashtu edhe trajtimi çnjerezor dhe poshtërues.

Elementi i fundit nga renditja, por aspak për nga rëndësia është subjekti i posaçëm i kësaj vepre penale. Nga dispozita e nenit 86 të Kodit Penal del se subjekti i veprës penale të torturës është vetëm personi që ushtron funksione publike, i cili duhet t'i përdorë këto cilësi në kryerjen e veprës penale, por edhe vepra penale që kryhet duhet të kërkojë përdorimin e këtyre cilësive.

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë sanksionon parime të rëndësishme lidhur me mbrojtjen e dinjitetit të njeriut, ndalimin e torturës dhe trajtimit çnjerezor apo degradues nga ana e organeve shtetërore. Në kapitullin VII të saj, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë e ka zgjidhur raportin dhe hierarkinë midis normave të brendshme dhe të jashtme, procedurat e hierarkisë së normave ndërkombëtare në rendin juridik të brendshëm, si dhe kompetencat e organeve përkatëse në këtë fushë.⁸² Kështu, sipas nenit 5 të Kushtetutës, Republika e Shqipërisë zbaton të drejtën ndërkombëtare të detyrueshme për të, duke u dhënë fuqi detyruese normave ndërkombëtare në rendin e brendshëm juridik, ndërsa sipas nenit 116 të Kushtetutës⁸³, përcaktohet vendi që zënë normat e së drejtës ndërkombëtare në hierarkinë e normave të zbatueshme në Republikën e Shqipërisë, ku marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara zënë vendin e dytë pas Kushtetutës. Po ashtu, neni 17 i Kushtetutës i njeh një status të veçantë K.E.D.NJ.-së në krahasim me marrëveshjet e tjera ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë kur përcakton shprehimisht se kufizimet e parashikuara në K.E.D.NJ. nuk mund të tejkalohen nga sistemi i brendshëm ligjor. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë i ka dhënë një rol të posaçëm mbrojtjes së të drejtave dhe lirive themelore të njeriut në pjesën e dytë të saj, duke i vendosur ato në themel të rendit juridik si të pandashme, të patjetërsueshme e të padhunueshme.⁸⁴

⁸² Shih L. Omari, A. Anastasi, E drejta kushtetuese, Shtëpia botuese ABC, Ribotim, Tiranë, 2010, fq. 55.

⁸³ Neni 116 paragrafi i parë i Kushtetutës: Aktet normative që kanë fuqi në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë janë: a) Kushtetuta; b) marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara; c) ligjet; ç) aktet normative të Këshillit të Ministrave.

⁸⁴ Shih V. Hysi, Respektimi i të drejtave të njeriut si garanci për shtetin e së drejtës dhe integritimin evropian, në Konferenca shkencore kombëtare “Sfidat e shoqërisë shqiptare në procesin e integritimit evropian”, Fakulteti i Drejtësisë (UT), Tiranë, fq. 6.

Dispozita kryesore në lidhje me mbrojtjen kundër torturës dhe dënimeve ose trajtimeve të tjera mizore, çnjerëzore apo degraduese është neni 25 i Kushtetutës ku sanksionohet se askush nuk mund t'i nënshtrohet torturës, dënimit apo trajtimit mizor, çnjerëzor ose degradues. Neni 25 është një dispozitë deklarative që synon të sanksionojë në Kushtetutë mbrojtjen e dinjitetit dhe integritetit fizik e mendor të individit dhe e cila nuk specifikon në mënyrë të detajuar përkufizimin e nocioneve.

Fillimisht, Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë i vitit 1995, në nenin 86 të tij të titulluar “Tortura”, përcaktonte se tortura, si dhe çdo akt tjetër çnjerëzor apo poshtërues dënohen me burgim nga pesë deri në dhjetë vjet, duke i dhënë kësaj dispozite natyrën e dispozitës së “bardhë” që nuk jep përkufizim ose detajim të koncepteve juridike të përfshira në të, ndërsa në nenin 87 të këtij Kodi nën titullin “Tortura me pasoja të rënda”, parashikohej se tortura, si dhe çdo akt tjetër çnjerëzor, kur ka sjellë gjymtimin, shëmtimin ose çdo dëmtim të përhershëm të shëndetit të personit apo vdekjen, dënohen me burgim nga dhjetë gjer në njëzet vjet.

2.3.Karakteristikat e torturës dhe trajtimeve çnjerëzore

Vepra penale e torturës manifeston këto karakteristika:

- a) Kryerës i kësaj vepre penale mund të jetë vetëm personi që ushtron funksione publike apo personi tjetër me nxitjen apo miratimin e tij, të hapur ose të heshtur.
- b) Viktimë e kësaj vepre penale mund të jetë çdo person ndaj të cilit zhvillohet një proces gjyqësor, apo thjesht për ta friksuar atë, dhe në çfarëdo forme tjetër bazuar në çfarëdo lloji forme diskriminimi.
- c) Akti i torturës nënkupton kryerjen ose moskryerjen e një akti me anë të të cilit me dashje personit i shkaktohet dhembja ose vuajtja e rëndë, qoftë fizike ose mendore, me qëllim të marrjes së informatës apo deklaratës nga personi i tillë ose nga personi i tretë, ose me qëllim të dënimit të personit të tillë për një vepër të cilën ai ose personi i tretë e ka kryer ose dyshohet se e ka kryer, ose për frikësimin apo shtrëngimin e personit ose të personit të tretë për arsye që kanë të bëjnë me diskriminim të çfarëdo lloji.
- d) Dënimi i parashikuar për kryerësin e kësaj vepre penale është nga një deri në 10 vjet burgim, e te rastet e torturës me pasoja të rënda deri në 20 vjet burgim.

Rrjedhimisht, edhe në rastin e trajtimeve çnjerëzore, ligjdhënësi e kanos kryerësin, varësisht shtrirjes së saj me dënim me burgim nga një deri në pesëmbëdhjetë vjet, dhe dënimin me burgim të përhjetshëm, në rastet kur i akuzuari akuzohet për kryerje të veprës penale të krimeve kundër njerëzimit.⁸⁵

3.Elementet e përbashkëta dhe dalluese në ndërlidhje me torturën dhe trajtimet çnjerëzore të manifestuara në Kodin Penal të Kosovës dhe Kodin Penal të Shqipërisë

Zgjidhjet ligjore sa i përket torturës dhe trajtimeve çnjerëzore midis Kosovës dhe Shqipërisë manifestojnë ngjashmëri evidente, por edhe dallime konkrete. Vështruar në këtë aspekt, fillimisht do të pasqyrohen ngjashmëritë, e më pas edhe dallimet që reflektohen në zgjidhjet e kodeve penale të dy këtyre shteteve. Rrjedhimisht, ngjashmëritë kanë të bëjnë me:

- a) Edhe Kodi Penal i Kosovës, por edhe Kodi penal i Shqipërisë ofrojnë përkufizime të qarta sa i përket torturës dhe kanosjes. Në të dy këto kode, tortura përkufizohet si veprë penale e posaçme, kurse sjelljet çnjerëzore si veprime kriminale manifestojnë shtrirje në një numër veprash penale të posaçme, por që në substancë hasen te krimet kundër njerëzimit dhe krimet e luftës. Në të dy rastet, tortura dhe sjellja çnjerëzore përkufizohen si vepra përmes të cilave një personi i shkaktohet vuajtje fizike e mendore, por te rasti i sjelljes çnjerëzore ato reflektohen në baza etnike, fetare etj., e tek kanosja ndaj një të pandehuri që të pranoj veprën që i vihet në barrë.
- b) Kodet penale të dy këtyre shteteve si kryerës të veprës penale të kanosjes dhe trajtimeve çnjerëzore konsiderojnë personat zyrtar- publik. Pra kryerësit e këtyre veprave penale nuk mund të jenë personat e rëndomtë, përveç atyre personave që këto vepra i kryejnë nën miratimin apo nxitjen e personit zyrtar.
- c) Kodi Penal i Kosovës dhe ai i Shqipërisë torturën dhe veprimet çnjerëzore i trajtojnë si vepra të rënda dhe për to parashikojnë dënime me burgim mbi dhjetë vjet. Natyrisht, ngjashmëria këtu qëndron në parashikimin e dënimit të dënimit më burgim të përhjetshëm për veprimet çnjerëzore të përfshira brenda krimeve kundër njerëzimit dhe krimeve të luftës.

⁸⁵ KPRSH, neni 74 dhe neni 75.

- d) Konform Kodit Penal të Kosovës dhe Kodit Penal të Shqipërisë tortura dhe sjelljet çnjerëzore mund të kryhen vetëm me dashje. Pra, këto vepra nuk mund të kryhen me formën e lehtë të fajësisë – pakujdesinë.

Ndërsa elementet dalluese në raport me torturën dhe sjelljet çnjerëzore që vijnë në shprehje në kuadër të Kodit Penal të Kosovës dhe Kodit Penal të Shqipërisë, kryesisht kanë të bëjnë me:

- a) Për dallim nga Kosova, Shqipëria me Kodin Penal të saj njih edhe torturën me pasojë të rëndë. Kjo vepër penale sipas këtij Kodi ekziston atëherë kur tortura ka sjellë gjymtimin, shëmtimin ose çdo dëmtim të përhershëm të shëndetit të personit apo vdekjen. Konsiderohet e nevojshme që edhe Kosova ta ketë në Kodin Penal të saj këtë vepër penale të posaçme.
- b) Dënimet për kryerje të veprës penale të torturës në Shqipëri ndëshkohen deri në dhjetë vjet burgim, e për torturë me pasojë të rëndë deri në njëzetë vjet burgim. Ndërkaq në Kosovë, për kryerësin e veprës penale të kanosjes Kodi penal kanos dënimin me burgim nga tre deri në 15 vite burgim. Konsideroj se do të ishte mirë që edhe në Kodin Penal të Shqipërisë të parashihej një minimum nën të cilin nuk mund të shqiptohej dënimi me burgim për dy format e kanosjes, siç e bën Kodi Penal i Kosovës.

Këto janë disa nga pikat e përbashkëta dhe dalluese midis Kodit Penal të Kosovës dhe Kodit Penal të Shqipërisë në relacion me rregullimin ligjor të kanosjes dhe të veprimeve çnjerëzore. Do shihej e nevojshme që midis këtyre dy kodeve, në të ardhmen e aftër, dallimet të eliminohen, duke sjellë zgjidhje të njëjta dhe që janë sa më afër qëllimit të dënimit.

Konkluzione dhe rekomandime

Mbrojtja nga tortura, trajtimet dhe dënimet çnjerëzore zënë një vend të rëndësishëm në kuadër të garantimit të të drejtave të njeriut. Veprimet e jashtëligjshme që përbëjnë torturë apo trajtim çnjerëzor cenojnë mbi të gjitha dy të mira bazë të çdo njeriu, sikurse është shëndeti dhe jeta e njeriut për të cilat çdo shtet ka detyrimin pozitiv t'i mbrojë dhe t'i garantojë. Për këtë arsye, ndalimi i torturës ka rëndësi për fusha të ndryshme të së drejtës ku mund të përmendim të drejtën ndërkombëtare penale, të drejtën ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe të drejtën e brendshme të çdo shteti si në fushën penale, ashtu edhe në fushën publike. Tortura e përdorur që në kohët antike nga popuj të ndryshëm ka pësuar ndryshimet e saj lidhur me format dhe qëllimet për të cilat është përdorur, por po ashtu kanë pësuar ndryshime edhe mënyrat e ndalimit që i janë bërë në periudha të ndryshme kohore. Tortura e përdorur për të marrë çdo informacion të mundshëm në procesin gjyqësor ka pësuar ndryshime me zhvillimin historik të procesit penal dhe reformimin e tij deri në shfuqizimin e saj, duke i dhënë fund kështu diskutimit mbi torturën gjyqësore dhe aplikimin e saj. Tortura dhe ndalimi i saj për personat e dënuar gjatë vuajtjes së dënimit ka ndryshuar nëpër shekuj, duke përfshirë këtu ndryshimet në kufizimin e lirisë për shmangien e tyre ndaj gjyqimit, në ndëshkimin e autorit të veprës penale dhe parandalimin e kriminalitetit për të konsoliduar rendin publik duke e torturuar ose turpëruar atë publikisht e deri në përpjekjet e para të një ideologjie të re të ndëshkimit me qëllim riedukimin e të dënuarit në shekullin XVI. Në këtë periudhë vihen re gjithashtu hapat dhe idetë e para për ndërtimin e një institucioni të mirëfilltë penitensiar, ku një ide moderne mund të konsiderohet ajo e Jeremy Bentham-it. Ky i fundit zhvilloi rreth viteve 1790 modelin “Panoptikon”, i cili po studiohet nëpërmjet një projekti 3D.

Garantimi i ndalimit të torturës dhe trajtimeve çnjerëzore ka filluar që në gjysmën e dytë të shek. XIX dhe ka marrë një rëndësi të madhe menjëherë pas mbarimit të Luftës Botërore II, periudhë që përkon me miratimin e një sërë aktesh ndërkombëtare të cilat e vendosën në qendër individin në një pozitë më të lartë, ku të drejtat e tij kishin përparësi në raport me supremacinë absolute të shtetit.

Zhvillimet e së drejtës ndërkombëtare menjëherë pas Luftës Botërore II formuluan ndalimin e torturës si e drejtë absolute dhe e paderogueshme. Disa prej këtyre

instrumenteve ligjorë kanë sanksionuar ndalimin e torturës, ndërsa disa të tjerë kanë shkuar më tej duke parashikuar standardet ndërkombëtare dhe mekanizmat për mbrojtjen nga tortura, trajtimi dhe dënimi çnjerëzor ose degradues.

Dokumenti i parë ndërkombëtar që përpiqet të përcaktojë nocionin e torturës është Konventa kundër Torturës dhe Trajtimeve apo Dënimeve të Tjera Mizore, Çnjerëzore apo Degraduese, e njohur zakonisht si Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Torturës (U.N.C.A.T.). Te kjo Konventë janë referuar edhe shumë akte pasuese ndërkombëtare, si dhe shumë shtete kanë gjetur referimin për parashikimin në legjislacionin e tyre të brendshëm të këtij nocioni. Ky dokument ka vlera jo vetëm historike, por edhe sepse e konsideroi ndalimin e torturës dhe trajtimin çnjerëzor dhe degradues si një të drejtë absolute dhe të paderogueshme. Konventa solli edhe një risi sa i përket procedurës së hetimit nga vetë Komiteti në rastet e dyshimit për torturë. Më vonë, për ta bërë të efektshëm zbatimin e kësaj Konvente, Kombet e Bashkuara miratuan Protokollin Opsional të Konventës (O.P.C.A.T.) për krijimin e një sistemi parandalues për marrjen e masave efektive për të parandaluar veprimet e torturës dhe trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose degradues. Protokollin Opsional diktoi nevojën e krijimit në nivel kombëtar të Mekanizmave Kombëtarë për Parandalimin e Torturës (M.K.P.T.).

Një sërë aktesh të tjera ndërkombëtare në këto dekada janë miratuar për ndalimin e torturës dhe trajtimit çnjerëzor dhe degradues, ku një vlerë të rëndësishme pati miratimi i nenit 3 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Rëndësia e kësaj Konvente qëndron jo vetëm në numrin e të drejtave të përfshira në të, por gjithashtu në mekanizmat mbrojtës për hetimin e shkeljeve dhe garantimin e detyrimeve që rrjedhin nga kjo Konventë. Parashikimi i nenit 3 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut gjendet në një sërë Kushtetutash të vendeve të ndryshme evropiane të cilat i janë referuar në mënyrë eksplicite parashikimit të tij.

Pavarësisht miratimit të K.E.D.NJ.-së, Asambleja e Këshillit të Evropës e konsideroi të nevojshëm edhe krijimin e mekanizmave mbrojtës kundër torturës dhe trajtimeve çnjerëzore dhe degraduese. Për këtë arsye, Komiteti i Ministrave të Këshillit të Evropës miratoi Konventën Evropiane për Parandalimin e Torturës dhe Dënimeve apo Trajtimeve Çnjerëzore ose Degraduese, e cila konsiderohet gjerësisht si një nga traktatet më të rëndësishme të Këshillit të Evropës. Konventa nuk ofron përkufizime të torturës dhe

formave të tjera të keqtrajtimit, pasi qëllimi i saj kryesor ishte krijimi i Komitetit për Parandalimin e Torturës dhe Dënimeve apo Trajtimeve Çnjerëzore ose Degraduese (K.P.T.).

Një rol të rëndësishëm në respektimin e të drejtave të njeriut, përfshirë këtu edhe ndalimin e torturës dhe trajtimit çnjerëzor dhe degradues, e ka edhe Komisioneri për të Drejtat e Njeriut, i krijuar si një institucion jo gjyqësor nga Komiteti i Ministrave të Këshillit të Evropës, por me peshë në aspektin e rekomandimeve mbi respektimin e këtyre të drejtave. Me miratimin e Protokollit Nr. 14, Komisionerit iu dha e drejta për të marrë pjesë në seanca dëgjimore dhe për të paraqitur me shkrim si palë e tretë opinionin e tij në proceset gjyqësore pranë GJ.E.D.NJ.-së. Zyra e Komisionerit ka ndërhyrë në një numër të madh rastesh edhe kur aplikantët kanë pretenduar shkelje të nenit 3 të Konventës.

Shumica e rasteve të paraqitura përpara GJ.E.D.NJ.-së në shkelje të nenit 3 të K.E.D.NJ.-së kanë pasur natyrën e trajtimit çnjerëzor ose degradues, kjo për shkak se tërësia e elementeve të kërkuara për t'i konsideruar si torturë shpeshherë nuk ka qenë e plotë. Një jurisprudencë e zhvilluar nga ana e Gjykatës në këtë aspekt lidhet me detyrimet e shteteve anëtare për të siguruar kushtet e përshtatshme të të burgosurve në respekt të dinjitetit njerëzor, duke kërkuar që shëndeti dhe mirëqenia e tyre të sigurohen në mënyrë të përshtatshme. Po ashtu, Gjykata ka vënë theksin në vendimet e saj lidhur me mënyrën e ekzekutimit të masave që merren nga ana e administratës së policisë apo burgjeve me qëllim që ajo të mos shkaktojë vuajtje me intensitet që tejkalon nivelin e pashmangshëm të vuajtjes së natyrshme që vjen nga paraburgimi ose burgimi. Nën dritën e vendosjes së disa standardeve të reja lidhur me aspekte të nenit 3 nga Gjykata, numri më i lartë i pretendimeve të ngritura para kësaj Gjykate nga aplikantët lidhet me mungesën e kushteve në ambientet e privimit të lirisë, mbipopullimin e qelive, mungesën e kushteve higjieno-sanitare, dritës dhe shërbimit të përshtatshëm mjekësor.

Sipas jurisprudencës së GJ.E.D.NJ.-së, personat e arrestuar janë në një pozitë të dobët e të pambrojtur dhe autoritetet kanë për detyrë që t'i mbrojnë ata. I takon shtetit që të përgjigjet për çdo cenim të pësuar gjatë periudhës së ndalimit apo arrestimit dhe ky detyrim është veçanërisht strikt kur personi në fjalë vdes. Dhuna e ushtruar nga autoritetet që sjell si pasojë vdekjen e të dënuarit apo të paraburgosurit do të konsiderohet në çdo rast shkelje e

nenit 2 të K.E.D.NJ.-së, aq më tepër në rast se kjo e fundit ka ardhur si pasojë e torturës apo e një trajtimi çnjerëzor apo degradues.

Nga analiza e të dhënave rezulton se nga 47 vendet e Këshillit të Evropës, Turqia mban vendin e parë për numrin më të lartë të çështjeve të regjistruara për shkelje të nenit 3 pranë kësaj Gjykate. Në vend të dytë është Rusia dhe më pas renditet Rumania dhe Ukraina, mirëpo pavarësisht numrit të aplikimeve, Rusia mban vendin e parë, duke u gjendur fajtores nga GJ.E.D.NJ. për 62 vendime për torturë, 818 vendime për trajtim çnjerëzor dhe degradues si dhe 199 për mungesë të hetimit efektiv. Po ashtu, ekziston një numër vendesh të cilat nuk janë gjetur në asnjë rast fajtores nga Gjykata për shkelje të nenit 3 të Konventës si San Marino, Lihtenshtejni, Islanda, Monako dhe Andorra. Ndërkohë nga një analizë që u është bërë vendeve të cilat nuk janë anëtare të Bashkimit Evropian, Mali i Zi rezulton me më pak çështje të regjistruara për shkelje të nenit 3, ndjekur nga Shqipëria dhe nga Bosnje-Hercegovina. Shkeljet e të drejtave të njeriut, duke përfshirë aktet e torturës dhe trajtimet çnjerëzore apo degraduese, megjithëse me frekuencë dhe gravitet të ndryshëm, ndodhin në çdo vend enë të gjithë botën, pavarësisht nga gjendja e ekonomisë ose nivelit të demokracisë dhe shoqërisë civile. Për këtë arsye, shtetet kanë ndërmarrë një sërë masash për të plotësuar si “detyrimet negative”, ashtu edhe “detyrimet pozitive” me qëllim mbrojtjen e shtetasve nga veprimet dhe shkeljet e të drejtave të kryera nga palët e treta.

Në këtë këndvështrim ka nevojë për një rishikim të dispozitave të Kodit Penal lidhur me dënimin e torturës dhe trajtimit çnjerëzor ose degradues, për të qenë më të qarta dhe të zbatueshme. Me qëllim që këto dispozita të jenë në përputhje me K.E.D.NJ.-në dhe aktet e tjera ndërkombëtare, si dhe jurisprudencën e GJ.E.D.NJ.-së, duhet të mbahen në konsideratë disa aspekte nga ligjvënësi:

- a) Të jenë të qarta dispozita që dënojnë jo vetëm veprimet që konsiderohen si torturë por dhe ato që përbëjnë trajtim çnjerëzor ose degradues;
- b) Të rritet masa e dënimit, shikuar edhe në krahasim me vendet e tjera, të cilat kanë parashikuar se kur veprimet sjellin pasojë për jetën kanë një dënim të lartë, duke i specifikuar në kategori të posaçme, si të mitur etj.
- c) Të parashikohen qartë subjektet që dënohen, duke përfshirë jo vetëm zyrtarët publikë, por gjithashtu edhe subjektet private sikurse e kanë të parashikuar një pjesë e legjislacioneve të vendeve të Evropës si dhe të rajonit;

- d) Të parashikohet përgjegjësia e njëjtë e eprorit me vartësin në rastet kur eprori e urdhëron kryerjen e veprimeve që përbëjnë torturën, po ashtu si dhe rastet kur eprori i kupton rastet e torturës;
- e) Të përcaktohet qartë mos-përfitimi nga parashkrimi i ekzekutimit të vendimeve penale, mos-përfitimi nga masat e tjera më të buta me karakter amnistues, si dhe rastet e përjashtimit nga dënimi të këtyre subjekteve;
- f) Të bëhet parashikim më i zgjeruar i garancive procedurale në rastin e veprave penale të torturës.

Midis Kodit Penal të Kosovës dhe Kodit Penal të Shqipërisë, sa i përket rregullimit ligjor të torturës dhe sjelljes çnjerëzore ka ngjashmëri, por edhe disa dallime të vogla, të cilat do të ishte mirë të evitoheshin në të ardhmen duke bërë kombinimet më të mira të atij rregullimi.

BIBLIOGRAFIA

a) Libra dhe artikuj

A. Capone, Storia, cultura e principi nel processo penale, Universita degli Studi Mediterrani di Reggio Calabria, 2016.

A. Cullen, Defining Torture in International Law: A Critique of the Concept Employed by the European Court of Human Rights, vepër e cituar, fq. 42; shih O. Gross, F. Ni Aoláin, From Discretion to Scrutiny: Revisiting the Application of the Margin of Appreciation Doctrine in the Context of Article 15 of the European Convention on Human Rights.

A. Pugiotto, Pena di morte e dignità umana, Relacion për konferencën me të njëjtin emër “Pena di morte e dignità umana”të mbajtur në Universitetin e Milanos, Milano, 14 qershor 2018, në:<http://www.lifeimprisonment.eu/media/PDF/pugiotto%20pena%20di%20morte.pdf>.

A. Panebianco, Le doux supplice: La sentenza capitale nel diritto internazionale, Il caso degli Stati Uniti, Tezë diplome në Histori të Institucioneve Sociale dhe Politikave Evropiane, Universiteti i Bolonjës, 2014.

F. Imeri, S. Sheremeti, Nocioni i torturës, Juridica, Instituti Gjyqësor i Kosovës, fq. 53. Linku: <http://jus.igjk.rks-gov.net/678/1/Tortura%20Shqip.pdf>.

G. Serges, La tortura giudiziaria: Evoluzione e fortuna di uno strumento d'imperio, në L. Pace, S. Santucci, G. Serges, Momenti di storia della giustizia, Aracne, Roma, 2011.

G. Callandriello, Ristrette: Una storia minore, Premiceri editore srls, Padova, 2016.

I. Elezi, E drejta penale: pjesa e posaçme, Botimet Erik, Tiranë, 2008.

International Federation for Human Rights and Center for Constitutional Rights (FIDH / CCR), Discrimination, Torture, and Execution: A Human Rights Analysis of the Death Penalty in California and Louisiana, Nr. 618a, 2013.

J. Graven, Le problème des nouvelles techniques d'investigation au proces penal, në Revistën shkencore Revue de science criminelle et de droit penal compare, Nr. 3, botuar

nën kujdesin e Institutit të Kriminologjisë dhe Institutit të së Drejtës Krahësuese të Universitetit të Parisit, Paris, 1950.

J. Herrmann, Implementing the Prohibition of Torture on Three Levels, 2019.

J. Kidd, Torture and International Law: A Note on Recent Developments, në Revistën The University of Queensland Law Journal, Vol. 15, Nr.2, 1989.

L. Omari, A. Anastasi, E drejta kushtetuese, Shtëpia botuese ABC, Ribotim, Tiranë, 2010.

M. J. Garcia, U.N.CAT: Overview and Application to Interrogation Techniques, Congressional Research Service, 2009.

M. Nowak, E. McArthur, The United Nations Convention Against Torture - A Commentary, në Ph. Alston, V. Lowe (ed.), Oxford Commentaries on International Law, Oxford University press, Oxford, 2008.

M. Nowak, Torture and enforced disappearance, Geneve, 2010.

M. K. Addo, N. Grief, Does Article 3 of The European Convention on Human Rights Enshrine Absolute Rights, në Revistën shkencore European Journal of International Law, Vol. 9, Nr. 3, 1998.

O. Muçollari, Të drejtat ndërkombëtare të njeriut, Shtëpia botuese Mirgeeralb, Tiranë, 2015.

O. Vangjeli, E drejta për dinjtet njerëzor, trajtimi i të burgosurve sipas legjislacionit shqiptar dhe atij ndërkombëtar, në Konferencën shkencore kombëtare “Mekanizmat mbrojtës të të drejtave të individëve në kuadër të procesit të rregullt ligjor”, Departamenti i të drejtës publike, Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Tiranës, Botimet Pegi, Tiranë, 2012.

S. Schiavo, Cesare Beccaria, la tortura e i “romani legislatori”, në Diritto@Storia, Rivista internazionale di scienze giuridiche e Tradizione Romana (Revistë on-line), XV, Nr.14, 2016.

Troncone, Manuale di diritto penitenziario, Giappichelli editore, Torino, 2006.

T. Surlan, Prohibition of torture: absolute or relative?, në Revistën Shkencore “Bezbednost”, Nr. 3, Belgrade, 2016.

T. Buracchi, Origini ed evoluzione del carcere moderno, në Revistën ADIR – L’altro diritto (Revistë on-line), 2004.

V. Parlato, Pietro Leopoldo: Un principe riformatore, në Revistën shkencore Studi Urbinati, Vol.67, Nr. 3-4, Universiteti i Urbino, Urbino, 2016.

V. Hysi, Penologjia, Tirane, 2018.

V. Hysi, Respektimi i të drejtave të njeriut si garanci për shtetin e së drejtës dhe integrimin evropian, në Konferenca shkencore kombëtare “Sfidat e shoqërisë shqiptare në procesin e integritetit evropian”, Fakulteti i Drejtësisë (UT), Tiranë, 2020.

Y. Shany, The Prohibition Against Torture and Cruel, Inhuman, and Degrading Treatment and Punishment: Can the Absolute Be Relativized Under Existing International Law?, në Revistën shkencore Catholic University Law Review, Vol.56, Issue3, 2007.

Z. Alker, Building Bentham’s Panopticon, 2016, në Platformën: The digital Panopticon, Tracing London convicts in Britain & Australia , 1780-1925.

b) Ligje dhe vendime

Kushtetuta e Republikës së Kosovës, K-09042008.

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë (Ndryshuar me ligjet: nr. 9675, datë 13.1.2007; nr. 9904, datë 21.4.2008; nr. 88/2012, datë 18.9.2012; nr. 137/2015, datë 17.12.2015; nr. 76/2016, datë 22.7.2016; nr.115/2020, datë 30.7.2020; nr. 16/2022, datë 10.2.2022).

Kodi Penal i Republikës së Kosovës nr. 06/L-074.

Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë nr.7895, datë 27.1.1995.

Vendimi i Gj.E.D.NJ.-së, datë 07.07.1989, Soreing kundër Mbretërisë së Bashkuar (kërkesa nr.14038/88) .

Vendim i Gj.E.D.NJ.-së, datë 13.12.2012, El -Masri kundër Republikës ish-Jugosllave të Maqedonisë (kërkesa Nr., 39630/09).

Vendim i Gj.E.D.NJ.-së, datë 07.04.2015, Cestaro kundër Italisë(kërkesa Nr. 6884/11 & 236);

Vendim i Gj.E.D.NJ.-së, datë 29.10.2015, Hajrullahu kundër ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë, (kërkesa nr. 37537/07).

Vendim i Gj.E.D.NJ.-së, datë 19.01.2017, Singh dhe të tjerët kundër Greqisë (kërkesa Nr. 60041/13 & 58).

Vendim i Gj.E.D.NJ.-së, datë 30.05.2017, Grecu kundër Moldavisë (kërkesa nr. 51099/10 & 17).

Vendim i Gj.E.D.NJ.-së, datë 16.11.2017, Boukroukrou dhe të tjerët kundër Francës (kërkesa nr. 30059/15 & 77).

Vendim i GJ.E.D.NJ.-së, datë 31.05.2018, Abu Zubaydah kundër Lituanisë (kërkesa nr. 46454/11 & 629).

Vendim i GJ.E.D.NJ.-së, datë 31.05.2018, Al Nashiri kundër Rumanisë (kërkesa nr. 33234/12 & 665).

Vendim i GJ.E.D.NJ.-së, datë 10.07.2018, Abdulkadyrov dhe Dakhtayev kundër Rusisë (kërkesa nr. 35061/04 & 69) .

Vendim i GJ.E.D.NJ.-së, datë 10.07.2018, Abdulkadyrov dhe Dakhtayev kundër Rusisë (kërkesa Nr.35061/04 & 24, 71); Vendim i GJ.E.D.NJ.-së, datë 01.06.2017, Mindadze dhe Nemisitsverdize kundër Gjeorgjisë (kërkesa Nr. 21571/05 & 109).

Vendim i GJ.E.D.NJ.-së, datë 30.10.2018, O.R. dhe L.R. kundër Moldavisë (kërkesa nr. 24129/11 & 55).

Vendim i GJ.E.D.NJ.-së, datë 15.01.2019, Ilgiz Khalikov kundër Rusisë (kërkesa Nr. 48724/15 & 38).

Burime nga interneti

<https://www.ohchr.org/en/instruments-mechanisms/instruments/convention-against-torture-and-other-cruel-inhuman-or-degrading>

<https://www.biography.com/scholar/cesare-beccaria>

<https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=73754>

https://unmik.unmissions.org/sites/default/files/regulations/03albanian/A2000regs/RA2000_59.htm

https://www.drejtesia.gov.al/ep-content/uploads/2017/11/Kodi_Penal-1.pdf